

# INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË

Klima e investimeve, potenciali dhe barrierat

RAPORT HULUMTUES NGA INSTITUTI PËR EKONOMI  
TË TREGUT TË LIRË (IETL)



Instituti Për Ekonomi Të Tregut Të Lirë

## **RRETH IETL**

Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL) është organizatë e pavarur, jopartiake dhe jofitimprurëse për politika publike e themeluar nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), me seli në Prishtinë. Me qëllim të realizimit të misionit të vet, Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë kryen hulumtime të besueshme me fokus në temat kryesore ekonomike në sektorin privat në Kosovë dhe shfrytëzon rezultatet e hulumtimit për dialog të politikave dhe për të ndikuar në politikëbërje.

**Heqje e përgjegjësisë:**

Ky raport hulumtues u mbështet nga Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS). Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë raport janë vetëm të Institutit për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL) dhe nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e KAS-it ose Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) si themeluese e IETL-së. Përgjegjësia për informacionin dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport është tërësisht e IETL-së.

**Hulumtimi u krye nga:**

**Besa Zogaj Gashi**, Drejtoreshë Ekzekutive në IETL, bashkautore e raportit hulumtues.

**Serton Ajeti**, Analist i biznesit, bashkautorë i raportit hulumtues.

**Gent Beqiri**, Hulumtues i lartë në Institutin Riinvest, kontributi i të cilit ishte mbledhja e të gjitha informacioneve të nevojshme për bazën e të dhënave që u përdor për këtë studim dhe gjithashtu përpilimi i pyetësorit të anketës.

**Dizajni dhe faqorja  
Norë Potera****Botues:**

Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL), "Nëna Tereze" nr. 20, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës Uebfaqja: [www.ietl-oek.com](http://www.ietl-oek.com):Tel: +383 345 233 444 Llogo

Të drejtat e autorit ©2019 nga Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme automatike, apo të transmetohet, në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose metodë tjetër, pa leje paraprake me shkrim nga botuesi. Kontaktoni zyrën administrative të Institutit për Ekonomi të Tregut të Lirë për kërkesa të tilla.

## Falënderimet

Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL) dëshiron të shprehë mirënjohje të thellë ndaj Konrad-Adenauer-Stiftung në Kosovë (KAS) për partneritetin në këtë studim, pa të cilin nuk do të mund të realizohej ky botim.

Falënderime të veçanta shkojnë për të gjitha bizneset e huaja që pranuan të marrin pjesë në këtë anketë dhe të cilat bashkëpunuan me hulumtuesit në mënyrën më profesionale duke ofruar të gjitha informacionet në lidhje me bizneset e tyre si dhe pengesat me të cilat përballen.

Raporti i studimit do të përdoret nga zyrtarët qeveritarë, autoritetet lokale dhe të gjithë hisedarët përkatës, duke përfshirë studentët dhe personat e interesuar që trajtojnë Investimet e Huaja Direkte (IHD).

## Përmbledhje e përgjithshme

Qëllimi i këtij raporti hulumtues është nxitja e debatit përmbajtjesorë për barrierat me të cilat përballen investitorët e huaj në Kosovë (IHD); masat e politikave ekonomike që duhet ndërmarrë nga qeveria qendrore dhe lokale për t'i kapërcyer ato, dhe masat e kujdesit të mëpasshëm (kujdesi i mëpasshëm i referohet shërbimeve pas investimit) për investitorët ekzistues me qëllim të ruajtjes dhe zgjerimit të investimit të tyre (ri-investimet). Gjithashtu, përmes këtij studimi Instituti për Ekonomi të Lirë (IETL) ka ofruar informacione të vlefshme në lidhje me potencialin dhe arsyet pse të investohet në Kosovë për të vazhduar një debat të gjerë për hartimin e një strategjie të re nacionale e zhvillimit ekonomik cila do të ishte udhërrëfyes për reformat që duhet bërë në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik dhe tërheqjen e IHD.

Përkundër trendit pozitiv të IHD-ve në vitin 2019 (një rritje e vogël) në krahasim me vitin 2018, sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), IHD-të pësuan rënie të konsiderueshme gjatë vitit 2018 dhe 2017, duke lënë Kosovën si një vend jo tërheqës për investime të huaja e sidomos larg tërheqjes së investimeve nga korporatat dhe markat e mëdha botërore. Qeveria e Republikës së Kosovës (QeK) që nga shpallja e pavarësisë e deri më tani edhe pse ka shënuar përparim në disa faktorë që njihen se kontribuojnë në rritjen e IHD, përfshirë: politikën tatimore më të favorshme në rajon; liberalizimin; politikat e balancuara makroekonomike; infrastrukturën e mirë rrugore; stabilitetin ekonomik dhe sistemin e sigurt bankar etj, megjithatë hulumtimi tregon se: niveli i ulët i besueshmërisë institucionale, pengesat fiskale, pengesat administrative, korrupsioni, haraçi, krimi, vjedhja dhe ekonomia joformale<sup>1</sup> vazhdojnë të jenë pengesa kryesore për të bërë biznes në Kosovë dhe kërcënojnë mjedisin e biznesit për tërheqjen e IHD në Kosovë. Ndërkaq sa i përket perceptimeve të bizneseve të huaja për furnitorët, blerësit dhe klientët kosovar sipas rezultateve të anketës mësojmë se kanë besim të plotë duke dhënë mesazh pozitiv në këtë drejtim dhe mundësi për vazhdimin me investime dhe rritjen dhe zgjerimin e aktiviteteve.

Tutje, studimi tregon se paqëndrueshmëria poli-

tike luan rol të rëndësishëm në vendimin e investitorëve të huaj për të investuar kapitalin e tyre në vend. Në këtë kontekst, u tregua se ekziston pak besim në radhët e bizneseve të huaja ndaj qeverisë qendrore, si dhe ndaj autoriteteve lokale (47% e bizneseve të intervistuar kanë deklaruar se nuk kanë besim në pushtetin lokal dhe qendror) si dhe mungon koordinimi në mes këtyre dy niveleve të qeverisjes. Në këtë drejtim Kosova ka krijuar një shembull jo të mirë të mos-koordinimit institucional për politikat dhe veprimet për përkrahje të investimeve të huaja. Edhe pse është themeluar Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA); Këshilli Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik (KKZHE); Komisioni Ndërmarrësor për Investime Strategjike; Këshilli i Investitorëve Evropianë (KIE) për të promovuar dhe mbështetur klimën e investimeve në Kosovë; gjithashtu janë lidhur dhe nënshkruar marrëveshje të rëndësishme Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropë Qendrore (CEFTA); janë nënshkruar traktate të tatimit të dyfishtë me disa vende dhe në këtë drejtim, por sërish përvojat me ndërmarrjet e huaja që kanë shprehur interes për investime në Kosovë, na tregojnë se kanë perceptime jo të mira për shkak të një koordinim jo efikas ndër-institucional.

Hulumtimi tregon se pengesat administrative (licencimi, kostoja, koha, marrja e lejeve ndërtime, procedurat e tej zgjatura për përdorim të pronës komunale, mungesa e hapësirave biznesore (zona ekonomike) vazhdojnë të krijojnë probleme për bizneset e huaja.

Një tjetër gjetje me rëndësi është përmirësimi i mjedisit ligjor, përkatësisht forcimi i sundimit të rendit dhe ligjit. Edhe pse Kosova ka bërë shumë përparime në të bërit biznes si dhe në kompletimin e Kornizës Ligjore për Investime të Huaja Direkte (infrastruktura ligjore e rregulluar dhe e harmonizuar sipas standardeve të BE-së); sidoqoftë, përmirësimi i mjedisit ligjor, përkatësisht forcimi i sundimit të rendit dhe ligjit, sipas gjetjeve të hulumtimit është një ndër çështjet për të cilat qeveria e Kosovës duhet marrë masa më të shpejta si parakusht për funksionimin dhe zhvillimin e biznesit dhe tërheqjen e bizneseve të huaja. Rekomandohet se është e nevojshme që të themelohet një gjykatë komerciale për t'i trajtuar çështjet e tilla gjyqësore ku merren vendime të drejta, transparente dhe me kohë. Në këtë drejtim Oda Ekonomike e Kosovës

<sup>1</sup>Bazuar në Programin për Reforma në Ekonomi (PRE) 2019-2021, vlerësohet se madhësia e ekonomisë joformale (e hirtë dhe e zezë) në vitin 2015 ishte në 32% të BPV-së, e cila është dukshëm më e ulët se 43% e BPV-së e vlerësuar për vitin 2013 me një metodologji të krahasueshme.

(OEK)<sup>2</sup>, në përputhje me nevojat e biznesit brenda gamës së shërbimeve të saj, ka themeluar tribunalin e arbitrazhit, e cila në masë të madhe lehtëson zgjidhjen e problemeve të biznesit në mosmarrëveshjet biznesore vendore dhe ndërkombëtare.

Hulumtimi tregon se bizneset e huaja gjithashtu nuk janë të kënaqur në raport me furnizim me energji elektrike, e cila shpesh ndërpritet dhe nuk ka furnizim të rregullt duke krijuar shpenzime shtesë dhe konkurrencë të padrejtë.

Ndonëse Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, rini me njohuri të mira të gjuhës angleze dhe gjermane dhe fuqi punëtore me kosto të ulët, pavarësisht këtij fakti, vendi ynë ka shkallën më të lartë të papunësisë në Evropë. Sipas gjetjeve të anketimit del se bizneset e huaja kanë vështirësi në gjetjen e punëtorëve me shkathtësi të duhur. Mirëpo sipas rezultateve të anketës tregohet se perceptimet e bizneseve të huaja që operojnë në Kosovë kanë besim të plotë te punonjësit e tyre i cili është mesazh pozitiv për biznese të reja të huaja që janë të interesuara për të investuar në Kosovë.

Edhe pse rritja reale e Bruto Produktit Vendor (BPV) ka qenë mesatarisht rreth 4 për qind në vit që nga viti 2015, dhe krahasuar me vendet e rajonit në Ballkanin Perëndimor ka pasur rritje të vazhdueshme, por kjo normë e rritjes nuk ka ndikuar ta zbusë papunësinë dhe varfërinë dhe nuk ka gjeneruar mirëqenie të mirë jetësore për qytetarët e Kosovës. Rritja ekonomike e viteve të fundit bazohej kryesisht në rritje e investimeve dhe shpenzimeve kapitale të qeverisë si dhe konsumin e ekonomive familjare mirëpo ne kemi nevojë për një ekonomi që përqendrohet më shumë në prodhimtari dhe në rritjen e kapaciteteve të saj për eksport dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe tërheqje të IHD. Remitencat vazhdojnë të jenë një burim i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës, por përdoren kryesisht për të financuar konsumin e jo për investime të cilat do të kishin efekt në zhvillim ekonomik afatgjatë. Për fat të keq deri më sot, nuk ka pasur nisma, nga institucionet që remitencat të orientohen në investime.

Gjithashtu, Instituti IETL përmes këtij studimi jep informacion të vlefshëm në lidhje me potencialin dhe arsyet pse të investohet në Kosovë, siç janë: tatimet më të ulëta në rajon, përdorimi i euros si

<sup>2</sup>[https://www.oek-kcc.org/uploads/files/2018/May/24/2017\\_HAPJA\\_E\\_RRUGS\\_PR\\_BIZNES\\_M\\_T\\_MIR\\_N\\_KOSOV1527160051.pdf](https://www.oek-kcc.org/uploads/files/2018/May/24/2017_HAPJA_E_RRUGS_PR_BIZNES_M_T_MIR_N_KOSOV1527160051.pdf)

monedhë zyrtare, legjislacioni në përputhje me BE-në, vendndodhja strategjike dhe mundësi të mëdha investimesh sektoriale në sektorë të veçantë, siç janë: energjia; xehetaria; Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi (TIK) dhe sektori i nënkontraktimeve të biznesit "outsorce" (the Business Process Outsourcing -BPO); përpunimi i drurit dhe metaleve; agrobiznesi - përpunimi dhe paketimi i ushqimit; turizmi; tekstili etj. Një strategji e bazuar në sektor ia mundëson qeverisë qendrore dhe lokale të t'i fokusojnë resurset në sektorët që ofrojnë mundësitë më të mëdha të investimeve dhe maksimizojë përfitimet e IHD-ve në ekonominë vendore.

Deri më tani, Kosova ka shënuar përparim në privatizimin e pronave ose pasurive shoqërore. Investitorët potencialë, të huaj apo vendas, të gjithë trajtohen njësoj, në procesin e tenderimit. Sipas ligjit, në raste të veçanta, Qeveria e Republikës së Kosovës (QeK) ka të drejtë të negociojë drejtpërdrejt me investitorët e mundshëm pa kaluar nëpër procedurat tradicionale të tenderimit.

Si përfundim, sugjerohet që Qeveria e Republikës së Kosovës (QeK) të marrë disa masa për bizneset e huaja që investojnë në Kosovë, siç janë vendosja e pushimeve tatimore, mbulesa e pagave të punëtorëve në vitet e para, mbulesën e shpenzimeve të trajnimit; funksionalizim i plotë i zonave ekonomike të balancuara, krijimi i zonave të lira doganore; krijimi i më shumë hapësirave për parqet e biznesit. Këtë masa janë një ndër elementet kryesore të zhvillimit të sektorit privat si dhe do të ndikojnë në ruajtjen e investimeve, zgjerimin (ri-investimet ose zgjerimet nga investitorët ekzistues) dhe tërheqja e investimeve të huaja.

# Përmbajtja

<b>Lista e shkurtesave</b>	<b>8</b>
<b>Lista e figurave</b>	<b>8</b>
<b>Lista e tabelave</b>	<b>8</b>
<b>KAPITULLI I PARË: HYRJE</b>	<b>9</b>
1.1 Kuptimi i IHD-ve	9
1.2 Qëllimi dhe objektivat e hulumtimit	10
<b>KAPITULLI I DYTË: METODOLOGJIA E HULUMTIMIT</b>	<b>11</b>
2.1 Metodologjia e hulumtimit	11
2.1.1 Anketa me 38 sipërmarrje të regjistruara kosovare në sektorë të ndryshëm	11
2.1.2 Raportet zyrtare dhe të dhënat në dispozicion të publikut	11
<b>KAPITULLI I TRETË: ANALIZA DHE PREZANTIMI I TË DHËNAVE</b>	<b>12</b>
3. Gjetjet e anketës	12
3.1 Besueshmëria institucionale	12
3.2 Pengesat fiskale	13
3.3 Ligjet dhe implementimi	14
3.4 Pengesat administrative	15
3.5 Resurset njerëzore	18
3.6 Pengesat tjera	19
<b>KAPITULLI I KATËRT: PERSPEKTIVA EKONOMIKE</b>	<b>23</b>
4.1 Bruto Produkti Vendor	23
4.2 Treguesit fiskalë	23
4.3 Fuqia punëtore	23
<b>KAPITULLI I PESTË: PROFILI I KOSOVËS PËR IHD</b>	<b>25</b>
5.1 Trendi i flukseve hyrëse të IHD-ve, prejardhja dhe struktura e tyre (2015 - 2019)	25
5.2 Korniza ligjore për IHD në Kosovë	26
5.2.1 Ligji për Investime të Huaja	26
5.2.2 Ligji për Investime Strategjike	26
5.2.3 Platforma e dialogut mes qeverisë dhe investitorëve	27
5.2.4 Ligje tjera të rëndësishme lidhur me IHD-të	27
5.3 Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA)	28

5.3.1 Zona Ekonomike Rajonale e Ballkanit Perëndimor	28
5.3.2 Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA)	28
5.4 Sistemi tatimor në Kosovë	29
5.4.1 Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH)	29
5.4.2 Tatimi në të ardhurat e korporatave	29
5.4.3 Tatimi në të ardhurat personale	29
5.4.4 Kontributet pensionale	29
5.5 Dogana	29
5.6 Zonat ekonomike	29
5.7 Garancitë për investime	30
5.8 Privatizimi	30
<b>KAPITULLI I GJASHTË: ARSYET PËR INVESTIM NË KOSOVË</b>	<b>31</b>
6.1 Popullsia e re	31
6.2 Tatimet më të ulëta në rajon	31
6.3 Mjedisi i biznesit në Kosovë	33
6.4 Vendndodhja qendrore gjeografike	34
6.5 Regjimi i tregtisë së lirë	34
6.6 Stabiliteti ekonomik	34
6.7 Valuta stabile (Euro) dhe inflacioni i ulët	34
6.8 Telekomunikimet moderne	35
6.9 Sistem i sigurt bankar	35
<b>KAPITULLI I SHTATË: MUNDËSITË E INVESTIMIT</b>	<b>36</b>
7.1 Energjia dhe Minierat	36
7.3 Energjia	36
7.4 Teknologjia e Infomacionit dhe Komunikimi - TIK	36
7.5 Ndërtimtaria	37
7.6 Industria e tekstit	37
7.7 Përpunimi i drurit	37
7.8 Turizmi	38
7.9 Vreshtaria	38
<b>REKOMANDIME</b>	<b>39</b>
<b>REFERENCA</b>	<b>42</b>



## Lista e shkurtesave

AFP - Anketa e Fuqisë Punëtore  
ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës  
BB - Banka Botërore  
BE - Bashkimi Evropian  
BPV - Bruto Produkti Vendor  
BQK - Qendrore e Kosovës  
EUROSTAT - Zyra e Statistikave e BE-së  
IHD - Investimet e Huaja Direkte  
KIESA - Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë  
OECD - Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik  
QeK - Qeveria e Kosovës  
TIK - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi  
UNCTAD - Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim

## Lista e figurave

Figura 1. Besueshmëria institucionale - niveli i besimit të bizneseve të huaja ndaj institucioneve (qeveria qendrore, komuna, administrata tatimore, gjykatat, stafi, furnizuesit dhe blerësit) të Kosovës  
Figura 2. Perceptimet e bizneseve të huaja për shkallën e tatimore në Kosovë  
Figura 3. Perceptimet e bizneseve të huaja për funksionimin e doganave  
Figura 4. Lehtësimit e preferuara të bizneseve të huaja (ofruar nga niveli qendror dhe lokal)  
Figura 5. Perceptimet e bizneseve të huaja për zbatimin e ligjit dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor në Kosovë  
Figura 6. Mos zbatimi i kontratave në gjykatat e Kosovës  
Figura 7. Pengesat administrative  
Figura 8. Procedurat e licencimit  
Figura 9. Perceptimet lidhur me sigurinë e furnizimit me energji  
Figura 10. Perceptimet lidhur me procedurat për regjistrimin e biznesit në Kosovë  
Figura 11. Perceptimet e bizneseve të huaja lidhur me regjistrimi i pronës së biznesit  
Figura 12. Perceptimet e bizneseve të huaja lidhur me marrja e lejeve ndërtimore  
Figura 13. Përbushja e nevojave të bizneseve me fuqi punëtore të shkathët sipas kërkesave të tregut  
Figura 14. Niveli i kënaqshmërisë së bizneseve me punën e kryer nga punonjësit  
Figura 15. Perceptimet e bizneseve të huaja mbi shkallën e vështirësisë së qasjes në financa.  
Figura 16. Çka mendojnë bizneset e huaja për koston e financimit në Kosovë?  
Figura 17. Korrupsioni në Kosovë sipas bizneseve të huaja.  
Figura 18. Fenomeni i haraçit në Kosovë, sipas perceptimit të bizneseve të huaja.  
Figura 19. Krimi dhe vjedhja sipas perceptimit të bizneseve të huaja  
Figura 20. Perceptimet e bizneseve për linjat transportuese të Kosovë dhe afërsia me tregjet e rëndësishme  
Figura 21. Shkalla e papunësisë  
Figura 22. Shkalla e rritjes reale të BPV-së  
Figura 23. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponentëve  
Figura 24. Statistikat për IHD në 2019, për muaj deri në gusht 2019  
Figura 25. Distanca e udhëtimit nga Prishtina në Qendra Rajonale në kilometra (km)

## Lista e tabelave

Tabela 1. Krahasimi i normave tatimore midis Republikës së Kosovës dhe vendeve të rajonit  
Tabela 2: Krahasimi i normave të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore (Sigurimet) midis Republikës së Kosovës dhe vendeve të rajonit

# KAPITULLI I PARË: HYRJE

## 1.1 Kuptimi i IHD-ve

Në këtë studim, do të ofrojmë disa përkufizime të koceptit të IHD-ve që janë relevante në rastin e Kosovës (p.sh. struktura ekonomike e Kosovës, konteksti rajonal, konteksti politik etj.).

Sipas Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim (UNCTAD), Investimet e Huaja Direkte (IHD) përkufizohen si investim që përfshin marrëdhënie afatgjatë dhe pasqyron interes dhe kontroll të qëndrueshëm nga subjekti rezident në një ekonomi (investitori i huaj direkt ose ndërmarrja mëmë) në ndërmarrjen që është rezidente në një ekonomi të ndryshme nga ajo e investitorit të huaj direkt (ndërmarrje IHD ose shoqëri tregtare e kontrolluar ose filial i huaj). IHD nënkupton që investitori ushtron masë të konsiderueshme ndikimi në menaxhimin e ndërmarrjes rezidente në ekonominë tjetër. Një investim i tillë përfshin si transaksionin fillestar midis dy subjekteve ekonomike ashtu edhe të gjitha transaksionet pasuese ndërmjet tyre dhe midis filialeve të huaja, të inkuorporuara dhe të painkuorporuara. IHD-të mund të ndërmerren nga individët, si dhe nga subjektet e biznesit. IHD ka tre komponentë: kapitalin e ekuitetit, fitimet e riinvestuara dhe huat brenda kompanisë.

Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), IHD është një kategori e investimeve ndërkombëtare në të cilën një njësi rezidente në një ekonomi (investitori direkt) ndërmerr një interes të qëndrueshëm në një kompani rezidente të një ekonomie tjetër (ndërmarrje të investimit direkt). Interes i qëndrueshëm nënkupton ekzistencën e një marrëdhënie afatgjatë ndërmjet investitorit direkt dhe ndërmarrjes së investimit direkt si dhe një shkallë të rëndësishme influence në drejtim të kësaj të fundit. Termat "investitor direkt" dhe "ndërmarrje e investimit direkt", FMN-ja dhe OECD-ja i përkufizon kështu: Një investitor direkt mund të jetë individ, person juridik apo fizik, ndërmarrje publike, një qeveri, një grup individësh ose personash juridikë dhe/ose fizikë, të cilët zotërojnë një ndërmarrje investimi direkt me aktivitetet në një vend jashtë vendit të rezidencës së investitorit direkt. Një ndërmarrje investimi direkt është një person juridik apo fizik në të cilën një investitor i huaj ka pronësi 10% ose më shumë të aksioneve ose të fuqisë votuese të një shoqërie tregtare ose ekuivalente të një ortaku.

Sipas Zyrës së Statistikave të BE-së (EUROSTAT), IHD është kategori e investimeve ndërkom-

bëtare që pasqyron objektivin e realizimit të interesit të qëndrueshëm nga investitori i një ekonomie në një ndërmarrje rezidente në një ekonomi tjetër. Interesi i qëndrueshëm nënkupton që ekziston marrëdhënie afatgjatë midis investitorit dhe ndërmarrjes, dhe se investitori ka ndikim të rëndësishëm në mënyrën e administrimit të ndërmarrjes. Interesi i tillë zyrtarisht konsiderohet se ekziston kur investitori direkt zotëron 10% ose më shumë të fuqisë votuese në bordin e drejtorëve (për ndërmarrje të inkuorporuar) ose pjesën e barasvlershme (për ndërmarrje të painkuorporuar).

Sipas Bankës Botërore (BB), investimet e huaja direkte janë flukset hyrëse neto të investimeve për të realizuar interes të qëndrueshëm të menaxhimit (10 për qind ose më shumë të aksioneve të votimit) në ndërmarrjen që operon në një ekonomi të ndryshme nga ajo e investitorit. Kjo është shuma e kapitalit të ekuitetit, riinvestimi i fitimeve, kapitali tjetër afatgjatë dhe kapitali afatshkurtër siç paraqitet në bilancin e pagesave.

Nga ana tjetër, vendet ose kompanitë që duan të bëjnë investime direkte në një vend më të pak të zhvilluar kanë motive të ndryshme që nxisin vendimet e tyre. Motivet për investime të huaja në thelb kanë nevojën për të përfituar në maksimum në gjetjen e resurseve njerëzore me kosto më të ulët, në gjetjen e aseteve strategjike, gjetjen e tregjeve për të zhvilluar biznesin e tyre në mënyrë më të leverdishme, gjë që nuk është e mundur brenda vendeve të origjinës (Goedhuys, 2007).

Në këtë kontekst në përputhje me studimin nga Keane et al., (2010), Kosova është një nga vendet me popullsinë më të re në Evropë, ka shumë resurse të pashfytëzuara njerëzore dhe jonjerëzore dhe vuanë nga joefikasiteti i shfrytëzimit për shkak të mungesës së investimeve të mjaftueshme. Në Kosovë krahu i punës ofrohet me kosto të ulët; ka potencial të madh për zhvillim ekonomik dhe punësimin e të rinjve për shkak se janë normat tatimore të ulëta, legjislacioni në përputhje me BE-në, mundësi të mëdha për investime sektoriale; ndodhet në zemër të Ballkanit, ofron qasje të lehtë në Bashkimin Evropian (BE); vend kryesisht i pasur me resurse minerale (thëngjilli, zinku, plumbi, argjendi dhe kromi), e pasur me pyje, lumenj, male dhe tokë bujqësore produktive.

Investimet e huaja direkte në vendin tonë janë të një rëndësie strategjike, janë një faktor kyç për rritjen e aftësisë konkurruese të produkteve

kosovare në tregjet ndërkombëtare, për mbështetjen e rritjes ekonomike dhe rritjen e konkurrencës dhe prodhimtarisë në tregjet e vendit, por fatkeqësisht që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008 e deri më tani ende nuk e kemi nivelin e dëshiruar të IHD-ve.

## 1.2 Qëllimi dhe objektivat e hulumtimit

Qëllimi i këtij raporti të politikave është sa vijon:

- a) Vlerësim e mjedisit biznesor në Kosovë;
- b) Vlerësimin e perceptimit të investitorëve të huaj ndaj qeverisë qendrore dhe lokale;
- c) Identifikimi i barrierave (fiskale, legjislative, burimet njerëzore; administrative dhe gjyqësore) për IHD-të në Kosovë;
- d) Paraqitja e arsyeve pse të investohet në Kosovë,
- e) Të nisët një debat i gjerë mbi problemet që aktualisht prekin fluksin hyrës të IHD-ve në Kosovë, debat mbi masat e kujdesit të mëpasshëm që duhet ndërmarrë nga qeveria qendrore dhe lokale për investitorët ekzistues me qëllim të ruajtjes dhe zgjerimit të investimit të tyre (ri-investimet).
- f) Të jepen rekomandime specifike që mund të përdoren në proceset e politikë-bërjes për ruajtjen e investimeve të huaja, zgjerimin e investimeve të investitorëve ekzistues dhe tërheqjen e investimeve të huaja
- g) Të ofrohen rekomandime për hartimin e një strategjie të re nacionale e zhvillimit ekonomik e cila do të ishte udhërrëfyes për reformat që duhet bërë në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik dhe tërheqjen e IHD.

# KAPITULLI I DYTË: METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

## 2.1 Metodologjia e hulumtimit

Gjatë këtij raporti hulumtues, i kanë paraprirë një sërë aktivitetesh:

(i) Anketimi i 38 ndërmarrjeve Kosovare të regjistruara me pjesëmarrje të kapitalit të huaj.

(ii) Raportet dhe të dhënat zyrtare në dispozicion të publikut

### 2.1.1 Anketa me 38 ndërmarrje Kosovare të regjistruara me pjesëmarrje të kapitalit të huaj

Me qëllim të realizimit të raportit hulumtues, analizimit të gjendjes ekzistuese dhe identifikimit të barrierave për investimet e huaja në Kosovë, Instituti IETL ka përgatitur dhe implementuar anketën me kompani që kanë afarizëm me kapital të huaj. Mostra e bizneseve të huaja të intervistuar është përzgjedhur bazuar në metodën e mostrimit të rastësishëm.

Në pyetësor janë adresuar këto çështje kryesore:

- Shuma e investimeve të huaja;
- Investimet e huaja sipas sektorëve;
- Motivet e investimit;
- Identifikimi i barrierave;
- Mjedisi legjislativ, dhe
- Situata politike në Kosovë

Anketa përfshiu sektorë të ndryshëm të industrisë, si: industria e shërbimeve (TIK, dhe sektori i nënkontraktimeve të biznesit "outsourcing" (BPO); qendrat e thirrjeve, agjencitë e udhëtimit, ofrues të internetit dhe telekomunikimit, hotel-eri, industria e ndërtimit, prodhim, industria metalurgjike. Shumica e kompanive që ishin subjekt i anketës kishin realizuar mbi 5 milionë euro shitje gjatë vitit 2018. Kapitali i këtyre kompanive vjen nga vende nga kontinentet, si nga Evropa, Amerika, Azia, etj. Anketa u realizua përmes pyetësorit që përmbante 47 pyetje duke u fokusuar më shumë në identifikimin e barrierave me të cilat ballafaqohen investitorë të huaj në Kosovë duke filluar nga nga barrierat fiskale, pengesat legjislative/rregullatore, pengesat administrative, pengesat e resurseve njerëzore, sundimi i ligjit/përmbartimi i kontratave, situata politike etj. Anketa prodhoi rezultatet e dëshiruara, duke ofruar informacione për situatën reale në të cilën veprojnë bizneset e huaja, pengesa

dhe sfida, të cilat do diskutohen në mënyrë analitike në raport.

### 2.1.2 Raportet dhe të dhënat zyrtare në dispozicion të publikut

Me qëllim të begatimit të përmbajtjes së raportit hulumtues, në këtë studim hulumtuesit të Institutit IETL u mbështetëm në raporte të ndryshme dhe të dhëna zyrtare që janë në dispozicion të publikut. Këtu përfshihen të dhëna nga institucionet vijuese:

- Kuvendi i Republikës së Kosovës
- Agjencia e Kosovës për Promovimin e Investimeve (KIESA)
- Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK)
- Oda Ekonomike e Kosovës (OEK)
- Regjistri i Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtarë
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)
- Ministria e Financave (MF)
- Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ)
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)
- Zyra e Kryeministrit
- Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)

Burime të tjera që u konsultuan përfshijnë: ligje, raporte, artikuj dhe publikime të shoqatave të ndryshme, si dhe statistika publike (p.sh. Banka Qendrore e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës). U përdorën të dhëna sekondare të mbledhura nga interneti, broshurat përkatëse dhe botime të ndryshme. Janë konsultuar uebsajtet zyrtare të administratave tatimore/zyrave për të hyra publike të vendeve të rajonit për të analizuar sistemin tatimor në vendet e rajonit. Studimi gjithashtu i referohet të dhënave nga: EUROSTAT-Zyra e Statistikave e BE-së; OECD-Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik; UNCTAD-Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim; BB-Banka Botërore.

# KAPITULLI I TRETË: ANALIZA DHE PREZANTIMI I TË DHËNAVE

## 3. Të gjeturat kërkimore dhe analiza


Ky seksion i raportit do të japë një analizë të plotë të rezultateve të hulumtimit nga pyetësorët e realizuar me biznese të huaja në të gjithë Kosovën. Ai është organizuar në nën-seksione si në vijim për të pasqyruar strukturën e pyetësorit të përdorur në këtë hulumtim: besueshmëria institucionale; pengesat fiskale; ligjet dhe sistemi gjyqësor pengesat administrative, resurset njerëzore dhe pengesat tjera. Më poshtë, jepen të gjitha kategoritë që paraqesin

pengesa të rëndësishme për qëllimet e këtij studimi.

### 3.1 Besueshmëria institucionale

Niveli i besimit nga bizneset e huaja në tërë zinxhirin e institucioneve (qeveria qendrore, komuna, administrata tatimore, gjykatat, furnizuesit) luan rol të rëndësishëm në vendim-marrjen e bizneseve e huaja për të investuar dhe zgjeruar (ri-investuar) kapitalin e tyre në Kosovë nga njëra anë, dhe tërheqjen e investimeve të reja të huaja, nga ana tjetër.

Figura 1. Besueshmëria institucionale - niveli i besimit të bizneseve të huaja ndaj institucioneve (qeveria qendrore, komuna, administrata tatimore, gjykatat, stafi, furnizuesit dhe blerësit) të Kosovës



Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Bazuar në figurën 1, sipas rezultateve të anketës mund të vërehet se perceptimet e bizneseve të huaja që operojnë në Kosovë kanë besim të plotë te punonjësit e tyre, dhe ky është tregues shumë pozitiv për jo vetëm ruajtjen e fuqisë punëtore aktuale dhe rritjen e shkallës së mëtejshme të punësimit, por gjithashtu dërgon mesazh pozitiv për biznese të reja të huaja që janë të interesuara për të investuar në Kosovë.

Sa i përket furnizuesve me të cilin kanë punë bizneset e huaja, 93% e të anketuarve thonë se janë të kënaqur dhe kanë besim te furnizuesit e tyre (d.m.th. cilësia e mallrave/shërbimeve, livrimi me kohë, korrektësia, etj.), dhe vetëm 7.7% janë përgjigjur negativisht, se nuk kanë besim të plotë të furnizuesit nga Kosova. Kur

bëhet fjalë për blerësit dhe klientët kosovarë, ekzistojnë statistika të kënaqshme, sipas të cilave, 96% e bizneseve të intervistuar thonë se sa i përket klientëve/blerësve brenda tregut të Kosovës, ata kanë besim në shërbimet e tyre pas shitjes dhe janë të kënaqur me produktet/shërbimet e blera. Vetëm 4% e të anketuarve nuk kanë besim të plotë.

Në lidhje me administratën tatimore të Kosovës, 62.5% e bizneseve të huaja ekzistuese kanë besim në këtë institucion, ndërsa 37.5% nuk e ndajnë këtë besim. Kjo është statistikë që institucionet e QeK duhet ta trajtojnë dhe ta transformojnë administratën tatimore të Kosovës, përmes reformave të nevojshme, në një institucion në të cilin bizneset e huaja kanë besim të

plotë, si dhe të jetë institucion efikas. Një nga institucionet më të rëndësishme, në të gjithë zinxhirin e institucioneve, pa asnjë dyshim janë gjykatat, nga të cilat varet moszbatimi i kontratave dhe që kanë ndikim thelbësor në veprimtarinë dhe vendimet e bizneseve të huaja për të ri-investuar kapitalin e tyre në vend, përfshirë tërheqjen e IHD-ve të reja. Niveli i besimit në gjykatat e Kosovës është i ulët. Vetëm 52.4% e të anketuarve kanë deklaruar se u besojnë gjykatave të Kosovës, ndërsa 47.6% janë përgjigjur negativisht në lidhje me besimin që kanë këto biznese të huaja ndaj gjykatave. Forcimi i sundimit të rendit dhe ligjit, është një ndër çështjet për të cilat qeveria e Kosovës duhet marrë masa më të shpejta si parakusht për funksionimin dhe zhvillimin e biznesit dhe tërheqjen e bizneseve të huaja.


Pushteti vendor, institucionet dhe agjencitë e tjera përkatëse komunale në juridiksionin e të cilave ndodhet dhe vepron biznesi i huaj luajnë rol të rëndësishëm për të akomoduar dhe krijuar mjedis miqësor për bizneset e huaja. Në këtë drejtim, anketa ka gjetur se 71.4% e bizneseve që janë intervistuar thonë se i besojnë pushtetit lokal, ndërsa 28.6% kanë deklaruar se nuk kanë besim në pushtetin lokal dhe institucionet/agjencitë e tjera përkatëse komunale. Pothuajse identike janë përgjigjet e bizneseve të

huaja lidhur me qeverinë qendrore. 75% e të anketuarve kanë pohuar se kanë besim në qeverinë qendrore, ndërsa 25% kanë deklaruar se nuk i besojnë qeverisë. Në këtë drejtim Kosova ka krijuar një shembull jo të mirë të mos-koordinimit institucional për politikën dhe veprimet për përkrahje të investimeve të huaja. Një koordinim ndër-institucional dhe përqimi i një "mesazhi" të përbashkët institucional, është një ndër parakushtet kryesore për fuqizim të promovimit të mundësive për investime dhe rritje të IHD-ve.

### 3.2 Pengesat fiskale

Edhe pse krahasuar me vendet e rajonit Kosova ka normat më të ulëta në rajon dhe me gjerë, mirëpo gjithsej 55% të bizneseve të anketuara kanë deklaruar se normat tatimore në Kosovë ndikojnë negativisht në rentabilitetin e tyre. Vetëm 15% e bizneseve kanë deklaruar se normat tatimore janë brenda kufijve normalë dhe nuk paraqesin pengesë për biznesin e tyre, ku 30% e tyre i konsiderojnë tatimet pengesë të vogël (për informata me të detajuara, shih Figurën 2).

Figura 2. Perceptimet e bizneseve të huaja për shkallën e tatimore në Kosovë




Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Pjesë e hulumtimit ishte edhe perceptimet e bizneseve të huaja për funksionimi e doganave. Procedurat doganore i referohen të gjitha fazave që lidhen me lëvizjen ndërkufitare të mallrave në tregtinë e eksportit dhe importit. Çështjet që lidhen ngushtë me procedurën përfshijnë kodin e sjelljes, kategoritë e doganave, dokumentacionin e kërkuar dhe masat e tjera të veçanta. Siç tregojnë rezultatet e studimit, 36% e bizneseve të intervistuar pretendojnë se dogana është pengesë, dhe 8% thonë se është pengesë e madhe, që së bashku përbëjnë 44% të bizneseve

që besojnë se dogana është pengesë që prek seriozisht biznesin e tyre. Vështirësi të konsiderueshme janë shkaktuar nga kërkesat e rënda të dokumentacionit, burokracia e rëndë dhe zhdoganimi i ngadaltë. Ndërkaq 24% e të anketuarve pretendojnë se dogana paraqet pengesë të vogël, dhe 32% janë përgjigjur se dogana fare nuk bën pjesë në mesin e pengesave (për informata me të detajuara, shih Figurën 3)

Figura 3. Perceptimet e bizneseve të huaja për funksionimin e doganave




Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Sa i përket lehtësimeve të preferuara të bizneseve të huaja (ofruar nga niveli qendror dhe lokal), 44% të anketuarve thonë se dëshirojnë të kenë pushime tatimore për bizneset e tyre, veçanërisht në vitet e para të veprimtarisë, 3% thonë se lehtësimi më i mirë për bizneset e tyre do të ishte mbulimi i një përqindjeje të caktuar të pagave të punonjësve, 9% e bizneseve do të kishin nevojë për infrastrukturë themelore në vendet që ata i zgjedhin si vendndodhje të biznesit të tyre. Mirëpo, mjaft interesant është fakti që

44% e bizneseve thonë se do të kishin nevojë që shpenzimet e trajnimit të ofrohen nga qeveria. Kjo tregon dy gjëra: 1) punonjësit në Kosovë janë të pakualifikuar, që do të thotë që sistemi arsimor nuk ofron punë praktike për studentët, dhe 2) shpenzimet e trajnimit konsiderohen të konsiderueshme për t'u bartur nga bizneset. Prandaj, do të ishte mirë që Qeveria e Kosovës të mbështesë pako trajnimi për bizneset e huaja ekzistuese. (për informata me të detajuara, shih Figurën 4)

Figura 4. Lehtësimet e preferuara të bizneseve të huaja (ofruar nga niveli qendror dhe lokal)




Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

### 3.3 Ligjet dhe implementimi

Në pyetjen nëse ligjet dhe sistemi gjyqësor janë problem për bërjen e biznesit në Kosovë, 16% deklaruan se konsiderojnë se pengesë e madhe është mënyra si janë shkruar ligjet, si dhe funksionaliteti i sistemit gjyqësor në përgjithësi në

Kosovë. 42% e bizneseve janë përgjigjur se ligjet dhe sistemi gjyqësor në Kosovë mbetet pengesë, poashtu përqindja e njëjtë e bizneseve konsiderojnë se ligjet dhe sistemi gjyqësor është pengesë e vogël për të bërë biznes në Kosovë (për informata me të detajuara, shih Figurën 5).

Figura 5. Perceptimet e bizneseve të huaja për zbatimin e ligjit dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor në Kosovë




Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Një nga sfidat më kritike në Kosovë është përmbarimi i kontratave në gjykatat e Kosovës. Ky tregues paraqet barrë të madhe për bizneset në përgjithësi e veçanërisht, për bizneset e huaja që vijnë dhe investojnë në Kosovë, me perceptimin se ata do të gjejnë një mjedis miqësor, ku të drejtat e tyre do të mbrohen dhe respektohen. Megjithatë, në dekadën e fundit përmbarimi i kontratave ka qenë pengesë e madhe. Rezultatet e anketës nuk kanë dalë në kundërshtim me deklaratat e mëparshme. Në të vërtetë, siç shihet nga figura më poshtë, 33% e të anketu-

arve kanë deklaruar se mospërmbarimi i kontratave nga gjykatat e Kosovës është pengesë e madhe, 25% janë përgjigjur se është pengesë, 38% e tyre kanë deklaruar që është pengesë e vogël, ndërsa vetëm 4% kanë pretenduar se nuk është aspak pengesë (për informata me të detajuara, shih Figurën 6). Natyrisht, se qeveria duhet ta trajtojë këtë çështje dhe të përmirësohet në këtë tregues duke e adresuar këtë pengesë urgjentisht, nëse dëshiron të mbrojë bizneset ekzistuese dhe të tërheqë biznese të reja.

Figura 6. Mos zbatimi i kontratave në gjykatat e Kosovës



Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës


### 3.4 Pengesat administrative

Pengesat administrative (licencimi, kostoja, koha, marrja e lejeve ndërtimore, procedurat e tej zgjatura për përdorim të pronës komunale, mungesa e hapësirave biznesore (zona ekonomike) vazhdojnë të krijojnë probleme për bizneset, veçanërisht për investitorët e huaj. Sipas gjetjeve të studimit 47% e bizneseve të intervis-

tuara deklarojnë se pengesat administrative (si në nivelin lokal, ashtu edhe në nivelin qendror të qeverisjes) janë pengesë, 26% e të anketuarve kanë pohuar se janë pengesë e madhe, 16% e tyre janë përgjigjur se janë pengesë e vogël, dhe vetëm 11% kanë pohuar se pengesat administrative nuk paraqesin sfida për bizneset e tyre (për informata me të detajuara, shih Figurën 7).



Figura 7. Pengesat administrative




Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Në vazhdim të këtij nënseksioni do të diskutohet ndaras perceptimet e bizneseve të huaja lidhur me të gjitha pengesat administrative. Licencimi (d.m.th. koha, kostoja, kërkesat, aspekti administrativ, etj.) në Kosovë, sipas bizneseve, me sa duket paraqet sfidë. Sipas bizneseve të intervistuar, 21% e tyre kanë deklaruar se pajisja me licenca në agjencitë kosovare, është

pengesë e madhe, 33% e bizneseve kanë deklaruar se është pengesë dhe 21% e tyre kanë deklaruar se është pengesë e vogël. Është e evidente se licencimi duket të jetë sfidë. Vetëm 25% e bizneseve të intervistuar kanë deklaruar se procedurat e licencimit nuk paraqesin pengesë (për informata me të detajuara, shih Figurën 8).

Figura 8. Procedurat e licencimit




Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Në 20 vitet e kaluara, furnizimi me energji elektrike në Kosovë ka qenë sfidë e madhe në nivel vendi, e sidomos për bizneset edhe pse në vitet e fundit në një shkallë shumë më të vogël. Në vitet e fundit, furnizimi me energji është përmirësuar ndjeshëm. Siç është e evidentuar, 36% e tyre kanë deklaruar se më nuk është sfidë, 16% e tyre kanë deklaruar se kjo ende vazhdon të jetë pengesë e vogël, 24% e bizneseve kanë deklaruar se është pengesë, dhe 24% e tyre kanë deklaruar se është pengesë e madhe. Bazuar në

këto gjetje, institucionet e QeK duhet ta adresojnë këtë pengesë meqë ajo bën pjesë në çështjet themelore me të cilat asnjë biznes i huaj nuk duhet të përballë. (për informata me të detajuara, shih Figurën 9).

Figura 9. Perceptimet lidhur me sigurinë e furnizimit me energji




Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Në vitet e fundit, Kosova ka bërë punë të mirë në kuptim të treguesve për të bërit biznes. Sipas raportit të Bankës Botërore, Të Bërit Biznes në vitin 2018, Kosova bën pjesë në mesin e top 10-shes së ekonomive në mbarë botën për nga përmirësimi më i dukshëm në reformat e të bërit biznes, dhe në përgjithësi Kosova renditet e 40-ta në mesin e 190 vendeve për nga lehtësia e të bërit biznes, në krahasim me pozicionimin në vendin e 60-të vitin e kaluar. Ky fakt mund të dëshmohej nga rezultatet e anketës, ku shumica

e bizneseve, 78% e tyre, mendojnë se regjistrimi i biznesit në Kosovë nuk është aspak problem, 15% e tyre mendojnë se niveli i vështirësisë është i pjesshëm dhe nuk është problem, ndërsa vetëm 7% e bizneseve të huaja deklaruan se është e vështirë të regjistrohet një biznes në Kosovë. Si përfundim, Kosova i ka bërë reformat e duhura për të ulur në minimum pengesat administrative dhe burokratike në lidhje me regjistrimin e biznesit (për informata me të detajuara, shih Figurën 10).

Figura 10. Perceptimet lidhur me procedurat për regjistrimin e biznesit në Kosovë




Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Regjistrimi i pronës së biznesit duket se është pengesë e madhe në Kosovë. Kosova, sipas raportit të Bankës Botërore, Të Bërit Biznes në vitin 2018, renditet e 34-ta në mesin e 190 vendeve në të gjithë botën. Sidoqoftë, anketa me bizneset e huaja ekzistuese ka zbuluar se 55% e tyre kanë deklaruar se janë të pakënaqur lidhur me këtë tregues, ndërsa 34% janë përgjigjur se

janë të kënaqur, ndërsa 11% janë deklaruar si shumë të kënaqur. Si përfundim, një përqindje e madhe e bizneseve përgjigjet se regjistrimi i pronës afariste në Kosovë nuk është punë e lehtë, është e kushtueshme, kërkon shumë kohë, është burokratike. Kjo temë duhet të adresohet nga institucionet e QeK (për informata me të detajuara, shih Figurën 11).

Figura 11. Perceptimet e bizneseve të huaja lidhur me regjistrimi i pronës së biznesit




Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Shpesh aspektet burokratike, si marrja e lejeve ndërtimore në nivelin lokal dhe qendror, mund të krijojnë probleme dhe pengesa tejet të mëdha për bizneset e huaja më shumë se gjithçka tjetër. Në këtë drejtim, bizneset e kanë renditur këtë pengesë si vijon: 42% e tyre kanë deklaruar se është e vështirë, 29% e tyre janë përgjigjur se është shumë e vështirë, ndërsa 29% e bizneseve kanë pohuar se nuk është e vështirë të marrësh leje ndërtimore. Gjetjet e studimit korrespondo-

jnë me treguesin e marrjes së lejes ndërtimore nga raporti i Bankës Botërore Të Bërit Biznes për vitin 2018, sipas të cilit, Kosova renditet e 122-ta ndër 190 vende. Si përfundim, Kosova duhet të përmirësohet në këtë tregues, meqë është sfidë dhe pengesë e madhe për bizneset e huaja kur vendosen dhe fillojnë biznesin në Kosovë. (për informata me të detajuara, shih Figurën 12).

Figura 12. Perceptimet e bizneseve të huaja lidhur me marrjen e lejeve ndërtimore




Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

### 3.5 Resurset njerëzore

Tregu i punës në Kosovë me sa duket ofron bazë solide të krahut të punës për bizneset e huaja. Siç mund të shihet nga anketa lidhur me këtë pyetje, 8% e bizneseve kanë deklaruar se Kosova nuk i plotëson nevojat e bizneseve për fuqi punëtore. 16% e bizneseve konsiderojnë se kjo nevojë përmbushet pak nga punëtorët vendas,

55% besojnë se Kosova ofron fuqi punëtore që pjesërisht përmbush nevojat e bizneseve. Ndërsa, vetëm 21% janë të mendimit se Kosova plotësisht përmbush nevojat për fuqi punëtore të kualifikuar. Bazuar në gjetjet e anketës, është shqetësues fakti që shumica e bizneseve mendojnë se Kosova nuk është plotësisht në gjendje që të sigurojë fuqinë punëtore (për informata me të detajuara, shih Figurën 13).

Figura 13. Përmbushja e nevojave të bizneseve me fuqi punëtore të shkathët sipas kërkesave të tregut



**Në çfarë shkalle i përmbush tregu i punës nevojat tuaja për fuqi punëtore të shkathët?**


- Aspak
- Shumë pak
- Pjesërisht
- Plotësisht

Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Për sa i përket kënaqshmërisë së bizneseve me performancën e punëtorëve të Kosovës të punësuar në këto biznese, 52% e bizneseve thonë se janë shumë të kënaqur me performancën e punëtorëve që kanë punësuar, dhe 48% deklaro-

jnë se janë të kënaqur. Ky është sinjal i mirë, meqë treguesi i performancës është i kënaqshëm (për informata me të detajuara, shih Figurën 14).

Figura 14. Niveli i kënaqshmërisë së bizneseve me punën e kryer nga punonjësit



**Sa të kënaqur jeni me punën e kryer nga punonjësit?**

- Shumë të kënaqur
- Të kënaqur


Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

### 3.6 Pengesat tjera

Sipas studimit, qasja në financa nuk ka rezultuar të jetë pengesë e madhe. Siç shihet nga figura, shumica e bizneseve kanë deklaruar se qasja në financa nga bankat që operojnë në Kosovë nuk është aq e vështirë, ku 33% deklaruan se është pengesë e vogël, dhe 34% nuk e konsiderojnë fare pengesë. 22% e bizneseve kanë deklaruar se

huamarrja në bankat që operojnë në Kosovë është pengesë, ndërsa për pjesën tjetër prej 11% të tyre, është shumë e vështirë, dhe kështu, kjo paraqet pengesë të madhe. Shënim: huamarrja në bankat që operojnë në Kosovë varet nga shumë faktorë, periudha e të bërit biznes në Kosovë është një nga faktorët më të rëndësishëm, meqë kompanitë duhet të kenë dëshmi se janë të shëndosha financiarisht.

Figura 15. Perceptimet e bizneseve të huaja mbi shkallën e vështirësisë së qasjes në financa.




Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Kostoja e financimit në bankat komerciale në Kosovë nuk rezultojnë të jetë barrë e madhe. Anketa tregon se 27% e bizneseve kanë thënë se kostoja e financimit është e shtrenjtë dhe prandaj paraqet pengesë, 46% e tyre kanë renditur

koston e financimit si pengesë të vogël, ndërsa 27% e tyre janë përgjigjur se kostoja e financimit nuk është e shtrenjtë, dhe së këndejmi nuk është aspak pengesë.

Figura 16. Çka mendojnë bizneset e huaja për koston e financimit në Kosovë?




Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Korrupsioni është një nga pengesat më të mëdha me të cilat përballen investitorët e huaj në Kosovë. Ai shkatërron konkurrencën dhe bën që investitorët e huaj të ikin nga Kosova. Korrupsioni ka qenë dhe vazhdon të jetë pengesë e madhe, meqë ky studim tregon se 52% e bizneseve kanë deklaruar se paraqet pengesë të madhe, dhe vetëm 11% e tyre pretendojnë se nuk është pengesë. Korrupsioni në të gjitha nivelet e qeverisjes (lokale dhe qendrore), përf-

shirë institucionet e ndryshme përkatëse me të cilat bizneset duhet të merren për marrjen e licencave specifike, duhet të adresohet nga institucionet e QeK për të krijuar një mjedis korrekt dhe konkurrues të biznesit (për informata me të detajuara, shih Figurën 17).

Figura 17. Korrupsioni në Kosovë sipas bizneseve të huaja.




Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Haraçi, sipas studimit nuk duket pengesë e madhe në krahasim me disa vite më parë. 52% e bizneseve besojnë se haraçi nuk ekziston dhe nuk është pengesë, dhe vetëm 10% thonë se është pengesë e madhe. Megjithatë, kjo çështje

nuk do të duhej të shpërfillet dhe duhet të luftohet vazhdimisht nga autoritetet kosovare, meqë ky studim zbulon se për 19% të bizneseve paraqet pengesë, dhe kjo përqindje nuk është e vogël.

Figura 18. Fenomeni i haraçit në Kosovë, sipas perceptimit të bizneseve të huaja.




Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Krimi dhe vjedhja si dukuri shumë negative të jetës në përgjithësi, dhe të veprimtarisë afariste në veçanti, kanë ndikim negativ në mjedisin afarist në shumë forma. Sipas anketës, rezulton se krimi dhe vjedhja janë dukuri shqetësuese për bizneset e huaja. 50% e bizneseve kanë deklaruar se këto dy dukuri vazhdojnë të paraqesin pengesë të madhe, ndërsa pjesa tjetër prej 50% të bizneseve kanë deklaruar se ato

paraqesin pengesë të vogël apo nuk paraqesin pengesë, meqë ato nuk janë prekur nga këto dukuri.

Figura 19. Krimi dhe vjedhja sipas perceptimit të bizneseve të huaja




Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës

Afërsia ndaj tregjeve të rëndësishme është një aset, por Kosova është vend pa qasje në det dhe varet nga tranziti përmes vendeve tjera. Integrimi i përmirësuar premtan kosto më të ulëta të transaksioneve dhe tregje më të mëdha – ndaj ekonomi më të madhe të shkallës – si dhe më shumë konkurrencë dhe efikasitet më të madh.

nacional dhe lokal janë pengesë e madhe dhe pengesë dhe duhet përmirësuar, ndërsa dhe 14% e bizneseve janë përgjigjur se janë pengesë e vogël, ndërsa 29% kanë deklaruar se transportimi i mallrave dhe shërbimeve në dhe nga Kosova nuk është aspak pengesë. (për informata me të detajuara, shih Figurën 20)

Sipas rezultateve të studimit rreth 57% e të anketuarve kanë deklaruar se rrugët në nivelin

Figura 20. Perceptimet e bizneseve për linjat transportuese të Kosovës dhe afërsia me tregjet e rëndësishme



Burimi: Kalkulimet e autorit bazuar në gjetjet e anketës


# KAPITULLI I KATËRT: PERSPEKTIVA EKONOMIKE

## 4.1 Bruto Produkti Vendor

Sipas vlerësimeve tremujore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2018, vlera nominale e BPV-së arriti në shumën prej 6.5 miliardë euro, që në terma realë paraqet rritje prej rreth 3.9 për qind. Në mënyrë të ngjashme,

parashikimet e BQK-së për vitin 2018 sugjerojnë që ekonomia e Kosovës u karakterizua me rritje reale prej 4.0 për qind (figura më poshtë), që paraqet rritje më të ngadaltë në krahasim me një vit më parë, si rezultat i rritjes së kontributit negativ të komponentit të eksportit neto.

Figura 22. Shkalla e rritjes reale të BPV-së



Sipas parashikimeve të ASK-së, rritja e aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2018 u gjenerua kryesisht nga rritja e investimeve prej 14.7 për qind. Shpenzimet kapitale të Qeverisë u rritën me 13.4 për qind (5.4 për qind në 2017). Kontribut domethënës në rritjen e investimeve vlerësohet të ketë qenë rritja e huadhënies bankare, e cila u karakterizua me rritje dyshifrore gjatë gjithë vitit. Vetëm huat e reja për investime shënuan rritje vjetore prej 20.9 për qind në 2018. Gjithashtu, ndryshimet në politikën tatimore gjatë viteve të kaluara vlerësohet të kenë ndikuar në stimulimin e investimeve (burimi: Raporti Vjetor i BQK-së për 2018).

## 4.2 Treguesit fiskalë

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, të hyrat e buxhetit në vitin 2018 arritën shumë neto prej 1.76 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 4.5 për qind. Shpenzimet buxhetore arritën në 1.92 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 10.3 për qind. Si pasojë, buxheti i Kosovës shënoi deficit kryesor buxhetor prej 59.0 milionë euro në vitin 2017, ndërsa si pjesë e BPV-së, deficitin kryesor ishte 2.4 për qind. Në kuadër të të

hyrave, ka rritje më të lartë të të hyrave nga tatimet direkte që arritën në 267.5 milionë euro (rritje prej 12.4 për qind), ndërsa të hyrat nga tatimet indirekte shënuan rritje prej 2.2 për qind dhe arritën në 1.3 miliardë euro. Të hyrat jo-tatimore shënuan rritje prej 3.8 për qind dhe arritën në 192.9 milionë euro. Deri në fund të vitit 2018, borxhi publik arriti në 1.1 miliardë euro, që është për 9.7 për qind më i lartë në krahasim me vitin 2017. Si pjesë e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 17.1 për qind nga 16.6 për qind në 2017. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 17.8 për qind (i cili arriti në 676.6 milionë euro), ndërsa borxhi publik i jashtëm shënoi rënie prej 1.4 për qind, duke arritur në 416.4 milionë euro. Pjesa e borxhit publik të jashtëm në totalin e borxhit publik ka rënë në 38.1 për qind nga 42.4 për qind në 2017.

## 4.3 Fuqia punëtore

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla e papunësisë në Kosovë vlerësohet të jetë 29.6%<sup>3</sup>. Sipas burimit të njëjtë, shkalla e papunësisë është më e lartë në mesin e të rinjve dhe


<sup>3</sup><http://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/labour-force-survey-in-kosovo-2018>



grave. Kjo shkallë e lartë e papunësisë nuk pritet të zbutet në të ardhmen e afërt, për shkak të ekonomisë që nuk është në gjendje të krijojë vende të reja pune, dhe duke pasur parasysh që Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, dhjetëra mijëra të rinj hyjnë në tregun e punës

çdo vit duke gjetur se ka mundësi shumë të kufizuara punësimi. Por, nga ana tjetër, fuqia e punës karakterizohet me shkathhtësi të larmishme dhe nivele të ndryshme të arsimit dhe aftësimimit.

Figure 21. Shkalla e papunësisë




Shkalla e papunësisë sipas viteve 2011 – 2018 – Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, 2019

# KAPITULLI I PESTË: PROFILI I KOSOVËS PËR IHD


## 5.1 Trendi i flukseve hyrëse të IHD-ve, prejardhja dhe struktura e tyre (2015-2019)

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës, Investimet e Huaja Direkte (IHD) në vitin 2018 në Kosovë arritën në 213.7 milionë euro, që paraqet rënie prej 16.3 për qind në krahasim me vitin 2017. Brenda strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, por edhe investimet në instrumente të borxhit shënuan rënie (figura 23).

Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione arritën në 217.4 milionë euro, që është për 6.6 për qind më pak në krahasim me një vit më parë. IHD-të në formën e instrumenteve të borxhit arritën në -3.6 milionë euro (22.7 milionë euro në 2017). Rritja e IHD-ve u evidentua kryesisht në sektorin e pasurive të patundshme, sektorin e minierave, energji elektrike dhe tregti, ndërsa shërbimet financiare dhe sektori i ndërtimeve shënuan rënie.



Sa i përket origjinës së IHD-ve, shumica e IHD-ve erdhën nga Zvicra, Gjermania, Turqia, Mbretëria e Bashkuar, Shqipëria.



Këto të dhëna tregojnë fluksin e investimeve të huaja direkte që mbulon periudhën nëntë mujore në vitin 2019, duke treguar rritje të IHD-ve në krahasim me vitin 2018, veçanërisht në pjesën e dytë të vitit 2019.

## 5.2 Korniza ligjore për IHD në Kosovë

### 5.2.1 Ligji për Investime të Huaja

Investimet e huaja direkte në Kosovë rregullohen me Ligjin nr. 04/L-220<sup>4</sup> për Investimet e Huaja që ka për qëllim mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Kosovë, duke u ofruar investitorëve të huaj të drejta, masa mbrojtëse dhe garanci themelore. Qëllimi kryesor i këtij ligji, i cili shfuqizoi Ligjin nr. 02/L-33<sup>5</sup> është të përmirësojë klimën dhe kushtet e biznesit në mënyrë që të tërhiqen investimet e huaja dhe të sigurohet trajtimi korrekt i investitorëve në pajtim me standardet ndërkombëtare. Ligji rregullon të gjitha aspektet e investimeve të huaja, duke adresuar mosdiskriminimin, shpronësimin, respektimin e detyrimeve/ standardeve dhe ligjeve, dhe, ndër të tjera, mekanizmat për zgjidhjen e kontesteve lidhur me investimet. Përfshirja e të gjitha këtyre garancive në këtë ligj është në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe në përputhje të plotë me legjislacionin e BE-së. Ligji aktual për Investime të Huaja Direkte përmban 26 nene dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) është autoriteti përgjegjës, përmes mekanizmave të saj, të hartojë/krijojë dhe monitorojë politikën e zhvillimit për investimet e huaja.

Ligji nr. 02/L-33 për Investime përcakton që investimet e huaja përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- Pronën e luajtshme dhe të paluajtshme, duke përfshirë edhe të drejtat në pronën në fjalë si p.sh, hipotekën, barrën, pengun, dhënien me qira ose servitutin;
- Pronën e pa-prekshme dhe intelektuale, duke përfshirë të drejtat në pronën në fjalë, si dhe proceset teknike dhe njohuritë;
- Paratë e gatshme, letrat me vlerë, garancitë, aksionet ose llojet e tjera të interesave pronësore në një shoqëri afariste të Kosovës ose të huaj, bonot, fletë-obligacionet, ose instrumentet e tjera të kredisë;
- Kërkesat ose të drejtën në para, mallra, shërbime dhe përmbushjen e kontratës;
- Koncesione ose licenca të dhëna me ligj, akt administrative ose kontratë; dhe
- Fitimin e akumuluar me anë të një investimi në Kosovë ose diku tjetër.”

<sup>4</sup><https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8982>

<sup>5</sup>Ligji nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja, Official Monitor No. 1/09 January 2014.

Investitorët e huaj, teorikisht, gëzojnë trajtim të garantuar me ligj, i cili u jep atyre të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi si për investitorët vendas<sup>6</sup>. Ligji për investimet e huaja ofron gjithashtu garanci në lidhje me riatdhesimin e kapitalit dhe fitimit, dhe, për dallim nga ligji i mëparshëm, përkufizimi i investitorit të huaj përfshin edhe shtetasit kosovarë nga diaspora<sup>7</sup>. Duhet të theksohet se investitorët e huaj gëzojnë të drejtën për të zgjidhur kontestet e investimeve sipas kërkesave të rena dakord midis investitorëve të huaj dhe Republikës së Kosovës. Në mungesë të marrëveshjes së tillë, investitori i huaj ka të drejtë të kërkojë që kontesti i investimit të zgjidhet qoftë nëpërmjet procedurës gjyqësore në një gjykatë kompetente në Kosovë apo nëpërmjet arbitrazhit vendor dhe/ose ndërkombëtar<sup>8</sup>.

### 5.2.2 Ligji për Investime Strategjike

Krahas Ligjit për Investime të Huaja, Kuvendi i Kosovës para do kohe miratoi një nga ligjet më të rëndësishme në tërë historinë e tij, gjegjësisht Ligjin nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës. Ky ligj ka për qëllim nxitjen, tërheqjen dhe krijimin e kushteve për realizimin e investimeve strategjike në Republikën e Kosovës, si dhe të përcaktojë procedurat administrative dhe kriteret për vlerësimin, zgjedhjen, implementimin dhe mbikëqyrjen e projekteve strategjike si dhe përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Republikës së Kosovës, për qëllim të zbatimit të projekteve për investime strategjike (Ligji nr. 05/L-059 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës). Ligji mbulon sektorë të ndryshëm, siç janë Energjia, Infrastruktura dhe Minierat, Transporti dhe Telekomunikimet, Turizmi etj. Përkufizimet janë relativisht të njëjta me ato në Ligjin për Investime të Huaja. Ligji krijon më tej Komisionin Ndërmintor për Investime Strategjike. Jepet përshkrim i shkurtër i përgjegjësive të secilit institucion, gjegjësisht, Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve shërben si Sekretariat, ndërsa Komisioni, bazuar në secilin rast individual, nxjerr rekomandim për dhënien e statusit të investitorit strategjik. Rekomandimi thjesht jepet pas rekomandimit nga KIESA, përkatësisht në bazë të këshillave profesionale nga Grupi Operacional për përgatitjen dhe zbatimin e investimeve strategjike. Qeveria e Kosovës, nga ana tjetër, rezervon ekskluzivitetin e marrjes së vendimit për secilin çështje individuale.

<sup>6</sup>Ligji nr. 02/L-33 për Investimet e Huaja; Të drejtat e parapara me këtë ligj janë: mbrojtja dhe garancitë e vazhdueshme, trajtimi mosdiskriminues, kompensimi në rastet kur ka nacionalizim, shpronësim, shkelje të legjislacionit, dhe mbrojtja ndaj zbatimi retroaktiv i ligjeve.

<sup>7</sup>Përkufizimi në ligj jepet si: 'çdo person fizik që është shtetas i Republikës së Kosovës, por ka vendbanim jashtë vendit'. Për më shumë, shih Ligji për Investimet e Huaja, neni 1.3.2

<sup>8</sup>Ligji nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja neni 16: Mekanizmat për zgjidhjen e kontesteve të investimit

Ligji rregullon më tej Marrëveshjen për zbatimin e projektit strategjik, përdorimin e pasurive të paluajtshme të Kosovës gjatë zbatimit të projekteve strategjike, listën e projekteve të përgatitura nga autoritetet publike, transferimin e të drejtës për të përdorur pronën e ndërmarrjes publike te subjekti investues dhe dispozita të tjera të rëndësishme ligjore.

Ligji rregullon dhe ndërkohë Qeveria e Kosovës tashmë ka marrë vendim për lirimin nga tatimi prej 3 deri në 7 vjet për investimet e reja, varësisht nga vlera e investimeve dhe numri i të punësuarve. Ky vendim është i mirë, por duhet të krijohen lehtësira për të gjitha kategoritë e bizneseve (edhe për bizneseve të vogla e të mesme), e jo për biznese të mëdha në mënyrë të domosdoshme, sepse kjo e limiton mundësinë e njerëzve që kanë dëshirë, kanë shkathtësi, kanë kapacitet për të investuar e sidomos krijimin e kushteve kushte më të mira, që mërgimtarët tanë të investojnë kapitalin e tyre në Kosovë.

### 5.2.3 Platforma e dialogut mes qeverisë dhe investitorëve

Qeveria e Kosovës ka themeluar Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik (KKZHE), roli i të cilit është të organizojë dhe të harmonizojë aktivitetet e institucioneve shtetërore me qëllim të eliminimit të barrierave dhe adresimit të sfidave të të bërit biznes në Republikën e Kosovës.

Këshilli Kombëtar për Investime (KKI) është themeluar nga Qeveria e Kosovës dhe ka për qëllim koordinimin e procesit të financimit të projekteve infrastrukturore në Kosovë, dhe të sigurojë sinergji në mes të burimeve të ndryshme të financimit, përkatësisht buxhetit, huave dhe granteve.

Gjithashtu, disa dokumente strategjike të cilat i ka hartuar Qeveria e Kosovës lidhur me zhvillimin ekonomik të vendit dhe tërheqjen e investitorëve të huaj, janë si në vijim:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim si dokumenti kyç që paraqet prioritetet e larta qeveritare, ku edhe përfshihen masa që ndikojnë në tregti;
- Agjenda për Reforma Ekonomike, agjenda e reformave kyçe e dakorduar nga ana e Kryeministrit të Kosovës dhe Komisionerit të BE-së.
- Programi i Reformave Ekonomike – dokument i cili paraqet 20 masa kyçe që shërbejnë për thellimin e dialogut ekonomik në mes të Kosovës dhe BE-së.

Në Kosovë është themeluar Këshilli i Investitorëve Evropianë (KIE) që nga viti 2014. Qëllimi i themelimit të këtij Këshilli është:

- a) Të kontribuojë në përmirësimin e klimës së investimeve në Kosovë sa i përket legjislacionit

më të mirë dhe praktikave të biznesit në nivelin teknik që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e përditshëm dhe afatgjatë të biznesit.

- b) Të mbështesë përshtatjen e legjislacionit kosovar në procesin e integritimit të Kosovës në BE, duke siguruar inpute bazuar në përvojën e vendeve të ndryshme të BE-së,

- c) Të krijojë marrëdhënie dhe të bashkëpunojë me hisedarët e tjerë relevantë, duke përfshirë organizatat ndërkombëtare, organizatat e tjera afariste, përfaqësitë diplomatike dhe organizata të ngjashme të investitorëve të huaj në funksion të ndarjes së praktikave më të në mira dhe të promovimit të interesave të përbashkëta.

### 5.2.4 Ligje tjera të rëndësishme lidhur me IHD-të

Ligje të tjera të rëndësishme që ndërlidhen me investimet e huaja direkte janë: Ligji nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, Ligji nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike, Ligji nr. 02/L-75 për Arbitrazhin, Ligji nr. 2004/7 për Odën Ekonomike të Kosovës, Ligji nr. 2004/12 për Standardizimin (Rregullorja nr.2004/12), Ligji nr. 03/L-008 për Procedurën Përmbarimore, dhe Ligji nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

Të gjitha ligjet e lartpërmendura buruan nga strategjia qeveritare me qëllim plotësimin e boshllëqeve që ekzistonin në ligje të ndryshme. Kjo ishte e nevojshme për të kompletuar Kornizën Ligjore për Investimet e Huaja Direkte. Ishte e paarsyeshme të mendohet që vetëm me një Ligj për Investimet e Huaja, do të plotësohej Korniza Ligjore. Duhet theksuar se nuk ka mungesë të rëndësishme të dispozitave specifike të përcaktuara në ligje të ndryshme që mbrojnë Investitorin e Huaj. Në këtë drejtim, procedurat në lidhje me përmbarimin e kontratave rregullohen me Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe Ligjin për Procedurën Përmbarimore. Në përgjithësi, gjykatat themelore janë kompetente për përmbarimin e kontratave, me përjashtim të çështjeve që janë në juridiksionin e Gjykatës Komerciale, e cila është përgjegjëse për përmbarim (Nisma Ekonomike për Kosovën, 2011, nn).

### 5.3 Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA)

Në vitin 2015, Kosova nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian (BE). Marrëveshja përqendrohet në angazhimin e përbashkët të BE-së dhe Kosovës për të prom-

ovuar rritjen e qëndrueshme ekonomike në Kosovë. MSA krijon zonë të tregtisë së lirë midis Kosovës dhe BE-së ku standardet dhe ligjet e BE-së zbatohen në vend (Këshilli i BE-së, 2015). Ekzistojnë edhe dispozita të tjera në marrëveshje, siç janë bashkëpunimi në punësim, energji dhe arsim. Marrëveshja nuk përmirëson vetëm kushtet në vend, por gjithashtu mund të përmirësojë perceptimin e vendit. Nëse investitorët e huaj e shohin Kosovën si shtet ligjor që bashkëpunon me BE-në në sektorë të ndryshëm, bizneset do të ndihem më të sigurt dhe do të kenë më shumë besim për të investuar në vend (Këshilli i BE-së, 2015).

### 5.3.1 Zona Ekonomike Rajonale e Ballkanit Perëndimor

Përveç nënshkrimit të MSA-së, Kosova është pjesëmarrëse në nismën e BE-së për krijimin e Zonës Ekonomike Rajonale të Ballkanit Perëndimor; pjesëmarrës të tjerë janë Shqipëria, Bosnja, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia. Qëllimi kryesor i kësaj nisme është të krijohet një zonë e lëvizjes së lirë ku mallrat dhe shërbimet mund të lëvizin lirshëm, shumë ngjashëm me tregun e përbashkët të BE-së. Synim është që të thellohet integrimi ekonomik në rajon me shpresën përfundimtare të anëtarësimit në BE. Ndërsa Komisioni Evropian qëndron prapa planit për të ndihmuar, ndërsa u takon vetë vendeve që ta zbatojnë dhe rregullojnë. Për investime, pjesëmarrësit kanë rënë dakord të krijojnë axhendë rajonale të investimeve të përqendruar në shkëmbimin e informacionit dhe praktikat më të mira në politikat e investimeve. Në rastin ideal, kjo do të çojë në harmonizim të politikave të investimeve në të gjithë zonën. Ekziston fokusi për të stimuluar rritjen e sektorit privat për të maksimizuar përfitimet e mundshme nga marrëveshja ekonomike (Komisioni Evropian 2017).

Sa më shumë integrim që të ketë në të gjithë rajonin aq më tërheqës dhe konkurrues do të jetë ai. Tregu ballkanik nënkupton 20 milionë konsumatorë që kanë mbetur të paprekur nga 10 aktivitetet e tanishme ekonomike. Kjo do të inkurajojë më shumë IHD që do të krijojnë vende pune dhe rritje ekonomike. Kompanitë nga BE dhe Ballkani do të jenë në gjendje të punojnë më afër së bashku dhe të zhvillojnë marrëdhënie ose zinxhirë furnizimi. Ky integrim do të ishte tejet i dobishëm për Ballkanin dhe Kosovën posaçërisht ndërsa këto vende reformojnë institucionet dhe zhvillojnë ekonomitë e tyre me shpresën e anëtarësimit në BE. Ajo që bëjnë MSA dhe Zona Ekonomike Rajonale që do të tërheqë më shumë investime të huaja është se e bëjnë ekonominë e Kosovës më të madhe. Kosova ka popullsi më të vogël gjë që dekurajon investimet

për shkak të grupit të vogël të konsumatorëve. Me këto dy marrëveshje, tregu i Kosovës bëhet shumë më i madh dhe kjo e bën atë vend shumë më tërheqës për të investuar për shkak të qasjes në tregje të reja.

### 5.3.2 Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropë Qendrore (CEFTA)

MSA-në e plotëson CEFTA 2006<sup>9</sup>, instrumenti i dytë i BE-së për integrimin tregtar dhe zhvillimin ekonomik të rajonit të Ballkanit Perëndimor. CEFTA është marrëveshje tregtare midis vendeve jo-anëtare të BE-së në Evropën Qendrore dhe Juglindore, duke iu lejuar prodhuesve të tyre të hyjnë në tregun rajonal që përbëhet nga 25 milionë konsumatorë, pa asnjë detyrim doganor<sup>10</sup>. Marrëveshja synon krijimin e zonës së tregtisë së lirë në rajon deri më 31 dhjetor 2010.

Që nga 1 maj 2007, palët e marrëveshjes CEFTA janë: Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi dhe Serbia. Kriteret aktuale të anëtarësimit që nga takimi i Zagrebit në 2005:

- Anëtarësia në OBT ose zotimi për të respektuar të gjitha rregulloret e OBT-së
- Pasja e Marrëveshjes së Asociimit me Bashkimin Evropian
- Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë me vendet anëtare aktuale të CEFTA-s

Me rekomandimin e BE-së, anëtarët e ardhshëm do të përgatiten për anëtarësim duke krijuar zona të tregtisë së lirë. Një pjesë e madhe e tregtisë së jashtme të CEFTA-s është me vendet e BE-së.

Përveç kësaj, Kosova ka nënshkruar traktate të tatimit të dyfishtë me Shqipërinë, Maqedoninë, Slloveninë, Austrinë, Turqinë, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Mbretërinë e Bashkuar. Traktatet e vjetra me Hungarinë, Holandën, Gjermaninë, Finlandën dhe Belgjikën që nga koha e ish-Jugosllavisë ende vlejnë për Kosovën.

Kosova është anëtare e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit dhe anëtare e Procesit të Athinës për Energji në Evropë Juglindore, i njohur edhe si Traktati i Komunitetit të Energjisë. Më shumë informacion mbi marrëveshjet tregtare të Kosovës mund të gjenden në uebsajtin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

### 5.4 Sistemi tatimor në Kosovë

Politika tatimore në Kosovë është e orientuar

<sup>9</sup><https://www.rks-gov.net/EN/f133/foreign-economy/cefta>

<sup>10</sup><https://www.rks-gov.net/EN/f133/foreign-economy/cefta>

drejt rregulloreve të thjeshta të cilat sigurojnë bazë të gjerë tatimore dhe parandalojnë evazionin tatimor. Tatimet dallojnë në bazë të formës së biznesit dhe qarkullimit vjetor.

Administrata tatimore aplikon tre tatime kryesore plus kontributet pensionale si regjime kryesore tatimore<sup>11</sup>: Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH); Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK); Tatimi në të Ardhurat Personale (TAP) dhe Kontributi Pensional.

### 5.4.1 Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH)

Tatimi kryesor në Kosovë është Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH), i cili paguhet për mallra dhe shërbime. Norma tatimore është 18% dhe norma e reduktuar është 8%<sup>12</sup>. Bizneset që kanë qarkullim vjetor prej 30,000 € dhe më shumë duhet të regjistrohen për TVSH. Për sa i përket importit, periudha e pagesës së TVSH-së është 6 muaj dhe ajo arkëtohet në kufijtë administrativ të Kosovës.

### 5.4.2 Tatimi në të ardhurat e korporatave

Ky tatim paguhet çdo tre muaj, varësisht nga qarkullimi vjetor. Norma tatimore për korporata me qarkullim vjetor mbi 50,000 € është 10%.

### 5.4.3 Tatimi në të ardhurat personale

TKy lloj tatimi aplikohet në të ardhura nga paga, biznesi, qiraja, interesi, pasuria e patundshme etj. Normat tatimore të tatimit në të ardhura personale nga paga janë norma progresive duke u bazuar në lartësinë e pagës së fituar dhe njëherit norma më të ulëta në regjion dhe në shtetet e BE.

Normat tatimore janë:

- 0% për 0 deri 80 euro/muaj
- 4% për 80 deri 250 euro/muaj
- 8% për 250 deri 450 euro/muaj
- 10% për mbi 450 euro/muaj

<sup>11</sup><http://www.atk-ks.org/>

<sup>12</sup>Norma standarde e TVSH-së është 18%. Norma e reduktuar prej 8% vlen për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve vijuese: Furnizimi me ujë, përveç ujit të ambalazhuar; Furnizimi me energji elektrike, përfshirë shërbimet e transmissiionit dhe distribuimit, me ngrohje qendrore, mbledhjen e hedhurinave dhe trajtimin e mbeturinave tjera; Drithërat sikurse janë elbi, misri, varietetet e misrit, tërshëra, thekra, orizi dhe gruri; Prodhimet e bëra prej drithërave për qëllim të konsumimit njerëzor, sikurse janë mielli, brumërat, buka dhe prodhime të ngjashme; Vajrat për gatim të bërë nga drithërat apo farërat vajore për përdorim në gatim për konsumim njerëzor; Qumështi dhe produktet e qumështit me qëllim për konsumim njerëzor; Kripa e përshtatshme për konsum njerëzor; Vezët për konsum; Librat shkollorë dhe publikimet serike; Furnizimi duke përfshirë huadhënien e librave nga bibliotekat, përfshirë broshurat, fletëpalosjet dhe materialet e ngjashme të shtypura, librat me fotografi për fëmijë, librat për vizatim dhe ngjyrosje, librat e muzikës në formë të shtypur apo të dorëshkrimit, hartat dhe grafikët hidrografikë dhe të ngjashme; Pajisjet e teknologjisë së informacionit; Furnizimi i barnave, produkteve farmaceutike, institucioneve dhe aparateve mjekësore dhe kirurgjike; Pajisjet mjekësore, autoambulancat, ndihmat dhe aparatet tjera mjekësore me qëllim që të lehtësojnë ose trajtojnë paaftësinë për shfrytëzim ekskluziv të të paafteve, duke përfshirë riparimin e këtyre mallrave dhe furnizimin e ulëseve të fëmijëve për vetura.

## 5.4.4 Kontributet pensionale

Përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e llogarive individuale për kursimin e pensionit është Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). Ky tatim obligon të punësuarin por edhe punëdhënësin të kontribuojnë në financimin e pensionit të të punësuarit me normë prej 5% të pagës nga ana e të punësuarin dhe 5% nga ana e punëdhënësit<sup>13</sup>.

## 5.5 Dogana

Shërbimi Doganor jep kontributin e tij në çështjet ekonomike dhe të sigurisë. Arkëtimi i detyrimeve doganore si taksat doganore, tatimi mbi vlerën e shtuar, dhe akciza, derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës duke ndihmuar kështu zhvillimin ekonomik të shtetit. Gjithashtu, Dogana e Kosovës kontrollon importimin dhe eksportimin duke siguruar mbrojtjen e ekonomisë dhe mbrojtjen e markave tregtare, si dhe statistika të sakta për tregtinë e jashtme.

### Tarifat doganore në Kosovë sa i përket importit janë:

Tarifat doganore në Kosovë sa i përket importit janë:

- 0% për mallrat që importohen nga vendet e CEFTA-s, përveç Serbisë dhe B&H.
- 100% për mallrat e importuara nga Serbia dhe B&H në 100%.
- Tarifë progresive për mallrat që importohen nga vendet e BE-së, sipas MSA-së.
- 10% për mallrat që importohen nga vendet e treta.

## 5.6 Zonat ekonomike

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, nën mandatin e saj ka edhe zhvillimin e sektorit privat, duke përfshirë edhe sektorin për zhvillimin e zonave ekonomike. Zonat Ekonomike rregullohen me Ligjin për Zonat Ekonomike.

QeK ka krijuar 3 zona ekonomike (ZE) që janë në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe të Organizatës Botërore të Doganës: Ato janë: Zona e Lirë Ekonomike në zonën kadastrorë të Mitrovicës; Zona e Lirë Ekonomike në

<sup>13</sup><https://www.rks-gov.net/EN/f134/finance-taxes-customs/taxes>

<sup>14</sup>Gjatë nëntorit të vitit 2018, Qeveria vendosi të rritë detyrimin doganor për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnja në 100 për qind. Përveç kësaj, Qeveria detyroi Doganën e Kosovës të ndalojë hyrjen në Kosovë të mallrave me mbishkrime që nuk janë në përputhje me përshkrimin zyrtar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky vendim u mor një ditë pas dështimit të Kosovës për të siguruar anëtarësimin në Interpol, gjë që sipas Qeverisë së Kosovës erdhi si rezultat i fushatës së Serbisë. Arsyja për këtë vendim ishte shkelja e vazhdueshme e Marrëveshjes për Tregti të Lirë në Evropë Qendrore (CEFTA) nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina ndaj Kosovës. Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Vendim nr.76. Burimi: <https://bit.ly/2FJHLMH>

zonën kadastrorë të Gjakovës, dhe Zona e Lirë Ekonomike në zonën kadastrorë të Prizrenit, të cilat janë në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe Organizatës Botërore të Doganës.

Dhe zona të tjera ekonomike si: Parku i Biznesit Drenas, Parku i Teknologjisë Shtime, Zona Agro Industriale Suharekë, Zona Industriale Lipjan dhe Zonat Ekonomike, në Gjakovë, ku Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me komunat vazhdon të bashkë-investojë në mënyrë që të përfundojë infrastrukturën fizike.

Mirëpo funksionalizim i plotë i zonave ekonomike në të gjitha komunat e Kosovës përbën një sfidë dhe një faktor të rëndësishëm që duhet marrë me prioritet me qëllim të përmirësimit të ambientit afarist (krijimin e një ambientit fizik për bizneset vendore dhe ndërkombëtarë; tërheqjen e investimeve të reja (vendor dhe të huaja); grumbullimin e bizneseve në vende të përshtatshme për të bërë biznes; zgjerimi i industrisë ekzistuese; zhvillimin e lokaliteteve të caktuara).

## 5.7 Garancitë për investime

Agjencia Shumëpalëshe e Garantimit të Investimeve (MIGA) (anëtare e Grupit të Bankës Botërore) garanton investimet në Kosovë deri në shumën prej 20 milionë euro.

Korporata për Investime Private të Jashtme (OPIC) nga SHBA po ashtu ofron sigurime të riskut politik për investitorët e huaj në Kosovë.

Investimet dhe garancitë kreditore nga Austria - Austrian Kontrollbank (OeKN) dhe për Gjermani, Euler Hermes Kreditversicherung.

## 5.8 Privatizimi

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që shtrin veprimtarinë e vet në gjithë territorin e vendit. Agjencia ka mandat dhe autoritet të shesë ose transferojë ndërmarrjet dhe/ose asetet te blerësit investitorë privatë, ose t'i likuidojë ato. Për paraqitje grafike të rezultateve të shitjeve ose transferimit të pasurive, ju lutemi vizitoni uebsajtin e KPA-së<sup>15</sup>.

QeK është përpjekur të privatizojë asetet në pronësi publike që nga fillimi i viteve 2000. Asetet në pronësi të shtetit janë të larmishme dhe përfshijnë prona në sektorin e bujqësisë, minierave dhe mineraleve, dhe hotelerisë. Investitorët potencialë, të huaj apo vendas, të gjithë

trajtohen njësoj, në procesin e tenderimit. Në vitin 2016, QeK miratoi "Ligjin për Investime Strategjike" me shpresën e tërheqjes së investimeve të huaja. Fokusi kryesor i ligjit është transferimi i pronësisë së ndërmarrjeve shoqërore te investitorët strategjikë. Ajo që e bën ligjin unik nga skemat e tjera të privatizimit është se, në raste të veçanta, ligji lejon që QeK të negociojë drejtpërdrejt me investitorët potencialë pa kaluar nëpër procedurat tradicionale të tenderimit.

Zyrtarët e AKP-së tregojnë se deri më tani janë privatizuar deri në 50 për qind të pronave ose pasurive shoqërore.

Sfidë për qeverinë e ardhshme rishikimi infrastrukturës ligjore për menaxhimin e pronës.

<sup>15</sup>[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

# KAPITULLI I GJASHTË: ARSYET PËR INVESTIM NË KOSOVË

Disa nga përfitimet nga investimi në Kosovë janë si më poshtë:

## 6.1 Popullsia e re

Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, 70% e popullsisë janë nën 35 vjeç. Gjuha shqipe dhe serbe janë të dyja gjuhë zyrtare në Kosovë, ndërsa për shkak të pranisë së madhe ndërkom-bëtare, gjuha angleze është vendosur si gjuhë e tretë zyrtare. Prandaj, numri i kosovarëve që flasin anglisht është shumë më i lartë se mesatarja rajonale. Rreth 25% e kosovarëve jetojnë në Bashkimin Evropian, kryesisht në vendet që flasin gjermanisht.

## 6.2 Tatimet më të ulëta në rajon

Tatimet e larta pengojnë krijimin e vendeve të punës dhe nxitjen për të investuar në një vend. Në këtë aspekt Kosova krahasuar me vendet e rajonit ka ngarkesë të ulët tatimore (të gjitha tatimet Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH); Tatimi në të ardhura personale (TAP) dhe Tatimi në të ardhurat e korporatave (TAK), ku normat tatimore janë më të ulëtat në rajon).

IETL përmes këtij studimi jep informacion të vlefshëm duke krahasuar ngarkesat tatimore në Kosovë me vendet e rajonit, përkatësisht në: Maqedoninë e Veriut, Serbinë; Bosnjën dhe Hercegovinën; Shqipërinë dhe Malin e Zi, e cila mund të ju shërbejë qeverisë në nivelin lokal dhe qendror për të promovuar tërheqjen e investimeve.

### Norma tatimore e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në Kosovë dhe vendet e rajonit

Aktualisht, në Kosovë janë tri norma për TVSH: (0%) për eksportet, (8%) për produktet esenciale dhe (8%) për produktet e luksit. Duke e krahasuar me vendet e tjera të rajonit Kosova renditet si një nga vendet me normën më të ulët të TVSH-së në rajon (për informata me të detajuara, shih Tabelën 1).

### Norma tatimore e Tatimit në të Ardhurat e Korporatave (TAK) në Kosovë dhe vendet e rajonit

Sa i përket normës tatimore për të ardhurat e korporatave (TAK), Kosova e ka (10%) dhe renditet pas Malit të Zi me (9%), ndërsa Serbia (15%), Shqipëria (15%) dhe Kroacia (18%) kanë normat më të larta të këtij tatimit në rajon (për informata me të detajuara, shih Tabelën 1).

### Norma tatimore e Tatimit në të Ardhura Personale (TAP) në Kosovë dhe vendet e rajonit

Përkitazi me normën tatimore për të ardhurat personale, Kosova aplikon normën më të favorshme krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Kosova aplikon norma progresive tatimore mujore të cilat fillojnë sinë vijim: norma tatimore prej (0%) vlen për paga 0 deri 80 euro/muaj; norma tatimore prej (4%) vlen për paga 80 deri 250 euro/muaj; norma tatimore prej (8%) vlen për paga 250 deri 450 euro/muaj; dhe norma tatimore prej (10%) vlen për paga mbi 450 euro/muaj. Tabela e mëposhtme tregon tatimet në vendet e rajonit:

Tabela 1. Krahasimi i normave tatimore midis Kosovës dhe vendeve të rajonit

Shteti	Tatimi		
	TVSH	Tatimi në të Ardhurat e Korporatave	Tatimi në të Ardhura Personale
Kosova	Norma standarde e TVSH-së është 18%	10%	0%- 4% 8% 10%
	Norma më e ulët e TVSH-së është 8%		
Maqedonia e Veriut	Norma standarde e TVSH-së është 18%	10%	10%
	Norma më e ulët e TVSH-së është 5%		
Serbia	Norma standarde e TVSH-së është 20%	15%	10%
	Norma më e ulët e TVSH-së është 10%		
Bosnja dhe Hercegovina	Norma standarde e TVSH-së është 17%	10%	10%
	Nuk ka normë të reduktuar të TVSH-së		
Kroacia	Norma standarde e TVSH-së është 25%	18%	36% <sup>16</sup>
	Norma më e ulët e TVSH-së është 13% <sup>17</sup>		

<sup>16</sup>Në Kroaci, Tatimi në të Ardhura Personale arkëtohet nga individët dhe zbatohet për burime të ndryshme të të ardhurave si puna, pensionet, kamatat dhe dividendet.

<sup>17</sup>Norma standarde e TVSH-së është 25% dhe norma më e ulët është 13% për akomodim, ushqim dhe gazeta.



Shteti	Tatimi		
	TVSH	Tatimi në të Ardhurat e Korporatave	Tatimi në të Ardhura Personale
Shqipëria	Norma standarde e TVSH-së është 20%	15%	23% <sup>18</sup>
	Norma më e ulët e TVSH-së është 10%		
Mali i Zi	Norma standarde e TVSH-së është 19-21% <sup>19</sup>	9%	9%
	Norma më e ulët e TVSH-së është 7% <sup>20</sup>		

Burimi: Zyrat e Administratës Tatimore në vendet e rajonit të përmendura në tabelë

## Kontributet e Sigurimeve Shoqërore

Meqenëse kontributet shoqërore rritin gjithashu kostot operative për çdo biznes vendas dhe të huaj, në marrjen e vendimeve për të investuar në një vend janë me rëndësi edhe informatat se cilat janë detyrimet e punëdhënësit në skemën e sigurimeve shoqërore. Tutje përmes këtij hulumtimi, Insituti IETL jep informacion të vlefshëm duke krahasuar normat e detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore (Sigurimet) midis Republikës së Kosovës dhe vendeve të rajonit përkatësisht në: Maqedoninë e Veriut, Serbinë; Bosnjën dhe Hercegovinën; Shqipërinë dhe Malin e Zi, bazuar në të dhënat e Zyrate të Administratës Tatimore në vendet e tyre.

Nga të dhënat (shih Tabelën 2) shihet se Kosova ka sistemin më të thjeshtë dhe më të favorshëm krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Në Kosovë aktualisht vetëm Kontributi Pensional është i detyrueshëm, i cili është më i thjeshti dhe

më i ulëti në krahasim me vendet e tjera të rajonit, me normën aktuale prej (10%) të ndarë në pagesa në vlerë prej (5%) të paguar nga punëdhënësi dhe (5%) të paguar nga punëmarrësi. Pavarësisht ekzistencës së Ligjit për Sigurimet Shëndetësore që parasheh normë prej (7%) në total përsëri të ndarë në pagesa prej (3.5%) të paguar nga punëdhënësi dhe (3.5%) të paguar nga punëmarrësi, megjithatë zbatimi i tij po del i pamundur për shkak të mungesës së buxhetit.

Vendet e tjera të rajonit aplikojnë kontribute të tjera të detyrueshme të sigurimeve shoqërore, përfshirë: sigurimet shëndetësore, sigurimet e punësimit dhe të papunësisë, të cilat ndikojnë në kostot operative të biznesit. Tabela 2, më poshtë tregon normat për kontributet e sigurimeve shoqërore në Republikën e Kosovës dhe vendet e rajonit.

Tabela 2: Krahasimi i normave të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore (Sigurimet) midis Republikës së Kosovës dhe vendeve të rajonit

Shteti	Kontributeve e sigurimeve shoqërore		Total
	Paguar nga punëdhënësi	Paguar nga punonjësi	
<b>Kosovo</b>	<b>5.0%</b>	<b>5.0%</b>	<b>10.0%</b>
Kontributi pensional	5.0%	5.0%	10.0%
Ligji për sigurimet shëndetësore* ende nuk zbatohet	N/A	N/A	N/A
<b>Maqedonia e Veriut</b>	<b>8.3%</b>	<b>24.0%</b>	<b>32.3%</b>
Sigurimet pensionale dhe invalidore	5.5%	15.0%	20.5%
Sigurimet shëndetësore	2.3%	8.5%	10.8%
Sigurimet e papunësisë	0.5%	0.5%	1.0%

<sup>18</sup>Në Shqipëri, Tatimi në të Ardhura Personale arkëtohet nga individët dhe zbatohet për burime të ndryshme të të ardhurave si puna, pensionet, kamata dhe dividendet.

<sup>19</sup>Ligji për TVSH-në në Mal të Zi është azhurnuar nga parlamenti për të përfshirë një rritje të normës së TVSH-së nga 19% në 21%. Ndryshimi do të hyjë në fuqi më 1 janar 2018.

<sup>20</sup>Norma e reduktuar e TVSH-së prej 7% vlen për artikujt themelorë ushqimorë, ilaçe, akomodim në hotele dhe shërbime turistike, ndër të tjera.

Shteti	Kontributeve e sigurimeve shoqërore		Totali
	Paguar nga punëdhënësi	Paguar nga punonjësi	
<b>Serbia</b>	<b>17.7%</b>	<b>20.3%</b>	<b>38.2%</b>
Pensionet	12.0%	14.0%	26.0%
Sigurimet shëndetësore	5.2%	5.5%	10.7%
Sigurimet e papunësisë	0.8%	0.8%	1.5%
<b>Bosnja dhe Hercegovina</b>	<b>10.5%</b>	<b>31.0%</b>	<b>41.5%</b>
Sigurimet pensionale dhe invalidore	6.0%	17.0%	23.0%
Sigurimet shëndetësore	4.0%	12.5%	16.5%
Sigurimet e papunësisë	0.5%	1.5%	2.0%
<b>Kroacia</b>	<b>17.0%</b>	<b>20.0%</b>	<b>27.0%</b>
Sigurimet shëndetësore	16.50%	20.0%	36.50%
<b>Shqipëria</b>	<b>16.7%</b>	<b>11.2%</b>	<b>27.9%</b>
Kontributet e sigurimeve shoqërore	15.0%	9.5%	24.5%
Kontributet e sigurimeve shëndetësore	1.7%	1.7%	3.4%
<b>Mali i Zi</b>	<b>10.3%</b>	<b>24.0%</b>	<b>34.3%</b>
Pensionet	5.5%	15.0%	20.5%
Sigurimet shëndetësore	4.3%	8.5%	12.8%
Sigurimet e papunësisë	0.5%	0.5%	1.0%

Burimi: Zyrat e Administratës Tatimore në vendet e rajonit të përmendura në tabelë

### 6.3 Mjedisi i biznesit në Kosovë

Sipas Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), mjedisi i biznesit në Kosovë po bëhet ndër më konkurruesit në rajon. Avantazhe të tilla tatimet shumë të ulëta në krahasim me vendet fqinje, sistemi tatimor i thjeshtë, regjistrimi i shpejtë dhe i lehtë i biznesit dhe ligjet transparente për investimet e huaja, e bëjnë Kosovën mjedis tërheqës dhe miqësor për investitorët e huaj. Për kompanitë që kërkojnë të investojnë në një vend ku kostot janë të ulëta dhe qasja në tregjet e BE-së Evropës Qendrore

dhe Ballkanit është e lehtë, Kosova paraqet opsion shumë tërheqës. Për herë të parë në Kosovë, një investitor mund të regjistrojë një biznes për 2 ditë, falas me zero kapital themeltar (për SHPK). Në raportin e Bankës Botërore, me tregues rreth Të Bërit Biznes, Kosova renditet në pozitën e 60-të në botë, duke konfirmuar përparimin e madh të shënuar nga Kosova në aplikimin e reformave dhe përmirësimin e mjedisit afarist në vend.

Sa i përket investimeve të huaja, ekziston Ligji për Investimet e Huaja, i cili mbron investitorët e

huaj dhe i trajton si të barabartë me investitorët vendas. Për të vepruar si biznes i ligjshëm, ndërmarrjet e huaja dhe vendase duhet të regjistrohen në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë<sup>21</sup>.

## 6.4 Vendndodhja qendrore gjeografike

E vendosur në zemër të Ballkanit, Kosova shërben si urë lidhëse midis vendeve të Evropës Juglindore, përmes transportit ajror, rrugor, hekurudhor dhe tre porteve detare, si në tabelën e mëposhtme.

Figura 25. Distanca e udhëtimit nga Prishtina në Qendra Rajonale në kilometra (km)

Qyteti	Kilometra	Qyteti	Kilometra
Shkup	86	Durrës	262
Sofje	279	Sarajevë	390
Selanik	329	Bari - Itali	531
Tiranë	256	Zagreb	741
Beograd	355	Budapest	747

Burimi: Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

## 6.5 Regjimi i tregtisë së lirë

Kosova është pjesë e CEFTA-s që nga viti 2007, dhe gjithashtu përfiton nga Sistemi i Preferencave Autonome Tregtare me BE dhe tregtia pa detyrime tarifore me SHBA, dhe lidhjet tregtare me Japoninë, Norvegjinë dhe Turqinë. Qasja e lirë në tregun e Bashkimit Evropian dhe tregjet fqinje lehtësohet me institucione moderne në mbështetje të bizneseve -Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian (BE) - është nënshkruar në tetor 2015 dhe është në fuqi nga 1 prill 2016. (Për më shumë detaje mbi MSA-në vizitoni: <https://mti.rks.gov.net/>)

- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me BE (28 vende), treg me mbi 500 milionë - i treti në botë për nga madhësia e popullsisë, pas Kinës dhe Indisë.
- Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropë Qendrore - CEFTA (2006) që përfshin 7 shtete jo-anëtare të BE-së: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi dhe Serbia, popullsia: 21 milionë.
- Programi i Sistemit të Përgjithshëm të Preferencave (GSP) me SHBA, Japoni dhe Norvegji.
- Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Turqinë.

<sup>21</sup>Për të vepruar si biznes i ligjshëm, ndërmarrjet e huaja dhe vendase duhet të regjistrohen në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në një nga kategoritë vijuese të bizneseve: 1. Biznes Individual, 2. Ortakëri e Përgjithshme, 3. Ortakëri e Kufizuar, 4. Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, 5. Shoqëri Aksionare, 6. Shoqëri e Huaj Tregtare, 7. Ndërmarrje Shoqërore, 8. Ndërmarrje Publike, 9. Kooperativë Bujqësore, 10. Ndërmarrje tjetër nën juridiksionin e AKM Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Investime të Huaja, ndërmarrjeve të huaja u lejohet të angazhohen në çdo veprimtari biznesi e cila është e hapur për bizneset vendase, dhe nuk ka asnjë kufizim për sa i përket kapitalit që mund ta kenë këto kompani. Investitorët e huaj mund të themelojnë degët e tyre në të njëjtën mënyrë si bizneset vendore.

## 6.6 Stabiliteti ekonomik

Zhvillimi ekonomik i vendit, i matur me bruto produktin vendor (BPV), ka qenë i favorshëm në vitet e fundit, duke treguar trend pozitiv dhe vazhdimisht në rritje, përkundër efekteve të krizës ndërkombëtare. Konsumi i sektorit privat dhe investimet janë faktorët më të rëndësishëm prapa rritjes ekonomike. Këto investime kryesisht po nxiten nga zgjerimi i shpejtë i sektorit financiar. Për më tepër, Qeveria e Kosovës zhvillon politikë stabile makroekonomike. Baza e të hyrave tatimore është zgjeruar duke mundësuar rritjen e shpenzimeve qeveritare dhe, për rrjedhojë, mbështetjen e rritjes ekonomike.

## 6.7 Valuta stabile (Euro) dhe inflacioni i ulët

EURO u bë monedhë zyrtare që përdoret në Kosovë më 1 janar 2002, duke eliminuar në këtë mënyrë riskun e monedhës dhe kursit të këmbimit. Në veçanti, euro i dha Kosovës një përparësi të konsiderueshme ndaj konkurrentëve të saj në rajon duke e bërë atë më tërheqëse për investimet e huaja dhe duke sjellë stabilitet financiar dhe makroekonomik që mungon në shumë vendeve të rajonit. Për më tepër, kjo i mundësoi Kosovës të ofrojë kostot më të ulëta të transaksioneve në rajon. Për shkak të mungesës së instrumenteve monetare që vijnë nga përdorimi i euros, Kosova nuk ka ndonjë risk të politikës

monetare. Çmimet pritet të mbeten stabile në të ardhmen.

## 6.8 Telekomunikimet moderne

Kosova ofron sisteme moderne të telekomunikimit, ashtu si ato të zakonshmet në vendet e zhvilluara të BE-së. Ekzistojnë 3 operatorë të telefonisë fikse dhe 2 operatorë të telefonisë celulare, që ofrojnë teknologjitë më të fundit dhe më moderne, duke përfshirë VoIP, GPRS, etj. Tre ofruesit kryesorë të shërbimeve të internetit ofrojnë internet stabile të brezit të gjerë frekuencor, duke përfshirë shërbime DSL, pa tel dhe kablllorike, me çmime më të ulëta se në çdo vend tjetër evropian. Sipas publikimit të Eurostat-it “Shifrat bazë për vendet në zgjerim” – Botimi 2019, në vitin 2018, Kosova ka përqindjen e familjeve që kanë qasje në internet në shtëpi më të lartën në Rajon (93%)<sup>22</sup>.

## 6.9 Sistemi i sigurt bankar

Gjatë viteve të fundit sektori financiar i Kosovës është ndërtuar mbi themele krejtësisht të reja. Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës (ABPK), themeluar në nëntor 1999, është organ i pavarur i cili vepron si Bankë Qendrore e Kosovës dhe rregullon me sukses sektorin bankar dhe të sigurimeve. Ka dhjetë banka të regjistruara, dhjetë Shoqata të Kursimeve dhe Kreditimit, dymbëdhjetë institucione mikro-financiare, katër institucione të tjera financiare jobankare dhe nëntë kompani të sigurimeve në Kosovë, duke përfshirë Uniqa Austria dhe Wiener Städtische. Bankat që operojnë në Kosovë janë: Banka Për Biznes, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Ekonomike, Komercijalna Banka, NLB Prishtina, Procredit Bank, Raiffeisen Bank Kosovo, Türkiye İş Bankası, TC Ziraat Bankası Kosova dhe TEB SH.A. Bankat e huaja mbizotërojnë në tregun bankar.

<sup>22</sup><http://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/kosovos-internet-access-is-higher-than-the-eu-average>

# KAPITULLI I SHTATË: MUNDËSITË E INVESTIMIT

Kosova ka një numër të sektorëve që ofrojnë mundësi të mira të biznesit siç janë:

## 7.1 Energjia dhe minierat

Kosova disponon me resurse të shumta natyrore, vlerësohet të ketë rreth 12.5 miliardë tonelata me rezervave të linjtit duke zënë vendin e pestë në botë me rezervat e kësaj xeheje. Rezervat e linjtit përdoren si burim kryesor i prodhimit të energjisë në Kosovë dhe vlerësohet të zgjasin për 650 vitet e ardhshme, me ritmin e nxjerrjes aktuale. Rezervat e linjtit janë gjithashtu të shpërndara në basenin e Dukagjinit dhe Drenicës, por nxjerrja e xehes aktualisht është e kufizuar vetëm në basenin e Kosovës.

Përveç linjtit, Kosova është gjithashtu e pasur me minerale të tjera si: alumini, ari, plumbi, zinku, bakri, boksiti, magnezi, azbesti, kromi, guri gëlqeror, mermeri dhe kuarci, zinku, çeliku, ari, kadmiumi, dhe bizmuti. Siç vlerësohet nga Banka Botërore, Kosova ka rezervat e mëdha të resurseve natyrore të cilat ende mbeten të pashfrytëzuara, ndërsa janë potencial i madh për rritje në të ardhmen.

Minierat Trepça: rreth 23,000 të punësuar, një kohë ishte ndër kompanitë më të mëdha në ish-Jugosllavi. Qeveria e Kosovës do të duhej të hartohet një strategji nacionale e zhvillimit ekonomik e cila do të ishte udhërrëfyes për reformat që duhet bërë në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik dhe një strategji të re për Trepçën. Për më shumë, ju lutemi vizitoni uebsajtin e Ministrisë së Kosovës për Zhvillim Ekonomik<sup>23</sup>.

## 7.2 Energjia

Pjesa më e madhe e furnizimit me energji të Kosovës bazohet kryesisht në linjit<sup>24</sup>. Aktualisht janë në funksionim dy termocentrale, Kosova A (5 njësi me 800 MW të instaluar) dhe Kosova B (dy njësi me 678 MW të instaluar). Kapaciteti aktual i këtyre impianteve është rreth 915 MW në tërësi. Qeveria është zotuar se do e mbyllë në një mënyrë të pranueshme ekonomikisht, ambientalisht, dhe shoqërisht Termocentralin 50 vjeçar Kosova A i cili ndotë shumë ambientin, por kjo do të rrisë zbrazëtirën e furnizimit me energji elektrike.

<sup>23</sup><https://mzhe-ks.net/sq/procedurat-per-investime-241#.Xf5FCEdKhPY>

<sup>24</sup>Kosova ka resurse shumë të mëdha linjiti, gjithsej 12.5 miliardë tonelata, për të cilat pretendon se radhitet e dyta për nga madhësia në Evropë dhe e pesta në botë

Një termocentral i ri me linjit me kapacitet 500 MW - Kosova e Re - është në zhvillim e sipër për shumë vite <http://bankwatch.org/our-work/projects/kosova-e-re-lignite-power-plant-kosovo>. Fillimisht ishte planifikuar si impiant prej 2000 MW, por mos gjetja e investitorëve gradualisht ka zvogëluar ambiciet.

Plotësimi i rritjes së kërkesës do të kërkojë rritjen e kapacitetit prodhues, arritjen e caqeve për energjinë e ripërtëritshme dhe efikasitetin e energjisë, zbatimin e reformave të tregut të parapara nga Komuniteti i Energjisë<sup>8</sup>, dhe përmirësimi i rrjetit të sistemit të transmissioinit dhe shpërndarjes.

Kosova ka potencial të konsiderueshëm të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), duke përfshirë: energjinë e ujit, energjinë e erës, energjinë diellore, biomasën, energjinë termike, etj. Për më shumë, ju lutemi vizitoni uebsajtin<sup>25</sup> e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Kosovës.

## 7.3 Bujqësia dhe blegtoria

Kosova është e pasur me tokë bujqësore; 53 përqind e sipërfaqes totale është tokë e punueshme. Aktualisht, sektori bujqësor kontribuon me vetëm 19 përqind të gjithsej njësisë vjetore të punës dhe 15 përqind të vlerës së eksportit. Përpunimi i ushqimit në Kosovë është menaxhuar tradicionalisht nga ndërmarrjet shoqërore, ndërsa sot ato janë joaktive; ndërmarrjet e reja private kanë filluar të operojnë në këtë fushë. Shumica e këtyre kompanive janë të vogla dhe nuk kanë kapacitet të plotësojnë pjesën më të madhe të kërkesave në treg. Investimi në këto kompani, sigurimi i teknikave të reja të menaxhimit mund të rigjallërojë industrinë e agro-përpunimit në Kosovë në atë masë sa të jetë konkurruese në tregjet ndërkombëtare.

## 7.4 Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi - TIK

Qeveria e Kosovës ka njohur rëndësinë strategjike të industrisë së TIK-ut për zhvillimin ekonomik dhe transformimin strukturor drejt një ekonomie të bazuar në dije. Si rezultat, në 2013 Qeveria e Kosovës zyrtarisht e shpalli industrinë e TIK-ut sektor me përparësi të lartë për ekonominë e saj. Sipas një Ankete të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të botuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK),

<sup>26</sup><https://mzhe-ks.net/sq/procedurat-per-investime#.Xf5IDkdKhPY>

sektori i TIK-ut në vend po rritet me shpejtësi, duke qenë një nga përparësitë e qeverisë për pesë vitet e fundit.

Kosova ka popullatën më të re në Evropë. Kjo popullatë është e aftë edhe flet shumë gjuhë të huaja, ku gjuha angleze është gati si një gjuhë zyrtare. Sipas publikimit të Eurostat-it "Shifrat bazë për vendet në zgjerim" – Botimi 2019, në vitin 2018, Kosova ka përqindjen e familjeve që kanë qasje në internet në shtëpi më të lartën në Rajon (93%).<sup>26</sup>

Kosova ka dalë si një nga vendet kryesore të Evropës si burim për ofrimin global të shërbimeve të TI-së. Sipas Global Sourcing Association (GSA), Evropa Juglindore - rajoni i Kosovës është bërë një vend tërheqës për gjetjen e burimeve /sektori i nënkontraktimeve të biznesit "out-source"; për shkak të kostos së ulët të stafit të kualifikuar dhe numrit të madh të profesionistëve të arsimuar, dygjuhësh dhe të kualifikuar të TI-së. Pothuajse 1/3 e kompanive të Kosovës janë të angazhuara në eksport të shërbimeve (sektori i nënkontraktimeve të biznesit "out-source" (the Business Process Outsourcing -BPO)).<sup>27</sup>

Shoqata International Association for Outsourcing Professionals ka zgjedhur Kosbit (<https://www.kosbit.net/>) në mesin e TOP 100 Global Outsourcing Providers. Kosbit po punon me kompani të tilla si AT&T, IBM dhe Cisco, dhe me përvojë mbi një dekadë ofron gamë të gjerë shërbimesh, eksternalizim të shërbimeve TI, zgjidhje globale të telekomit, integrim të sistemeve dhe shërbime të zhvillimit të softuerit për të ulur kostot e TIK-ut, përmirësuar ofrimin e shërbimeve dhe për të mundësuar rritjen e biznesit. Stellarion (<https://stellarion.fi/>) është kompani e themeluar në Finlandë nga partnerë finlandezë dhe kosovarë. Ajo është zgjeruar shpejt dhe punon me projekte AR/VR përfshirë projektin në zhvillimin e turizmit për qytetin e Hämeenlinna. Kompania amerikane Kode Labs, kompani e specializuar në IoT për 'pasuri të paluajtshme komerciale', bleu kompaninë kosovare Žag Apps, kompani e TI-së që zhvillon produkte softuerike. Këto janë vetëm disa shembuj për të treguar se sa i madh është potenciali i këtij sektori në Kosovë. Për më shumë, ju lutemi vizitoni uebsajtin e Ministrisë së Kosovës për Zhvillim Ekonomik.<sup>28</sup>

## 7.5 Ndërtimtaria

Viteve të fundit industria e ndërtimit është bërë

<sup>26</sup><http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/kosova-ka-qasje-ne-internet-me-te-larte-se-mesatarja-e-be-se>

<sup>27</sup><https://www.marketopportunities.fi/home/2019/ict-sector-in-kosovo/>

<sup>28</sup><https://mzhe-ks.net/sq/teknologjia-informative-telekomunikacioni#.Xf5LKEdKhPY>

ndër sektorët më të rëndësishëm në ekonominë kosovare. Ky sektor vazhdon të ketë potencial shumë të madh ekonomik për Kosovën, duke marrë parasysh nevojën për ndërtime të vendbanimeve të reja dhe infrastrukturës rrugore. BPV nga ndërtimtaria në Kosovë ishte mesatarisht 101.49 milionë euro nga 2011 deri në 2019, duke arritur shumën më të madhe ndonjëherë prej 195.70 milionë euro në tremujorin e dytë të 2019 dhe rekord të ulët prej 34.10 milionë euro në tremujorin e parë të 2011.

## 7.6 Industria e tekstilit

Sektori i tekstilit është i dyti për nga madhësia në Kosovë. Në kulmin e zhvillimit, 15 ndërmarrjet shoqërore të prodhimit të tekstilit kanë punësuar më shumë se 1,000 njerëz dhe kanë arritur shitje deri në 35 milion euro. Përkundër zhvillimeve të fundit në rajon, që kanë prishur lidhjet e tregtisë, analizat ndikojnë se nga 55 deri në 65 milionë euro mund të arrihen me eksportim, në rast të rikthimit të këtyre lidhjeve. Ky sektor është mjaft tërheqës për investitorët në mënyrë që edhe një herë Kosova të prodhojë produkte finale të veshjeve nga tekstili i prodhuar në rajon. Për më shumë, ju lutemi vizitoni uebsajtin e Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA).<sup>29</sup>

## 7.7 Përpunimi i drurit

Mbi 40% e tokës së Kosovës është e mbuluar me pyje, ose një sipërfaqe prej rreth 465.000 hektarë. Përpunimi i drurit konsiderohet si një nga sektorët më strategjikë me potencial të madh për rritje. Vëllimi total i tokës pyjore publike dhe private vlerësohet të jetë rreth 53 milionë m<sup>3</sup>. Të dhënat statistikore tregojnë se 75% e kompanive të përpunimit të drurit prodhojnë produkte finale; 18% prodhojnë produkte të ndërmjetme (gjysmë-finale), dhe 10% prodhojnë lëndën e parë. Shumica e kompanive të përpunimit të drurit kanë pasur tregues pozitiv në vitet e fundit (rritje pozitive në qarkullim, prodhim me vlerë të shtuar, rritje në numrin e të punësuarve, rritje në eksport).

Destinacionet kryesore të eksportit: Gjermania, Austria dhe Zvicra (kryesisht dyer, dritare, kuzhina dhe orendi), si dhe vendet e tjera të rajonit.

## 7.8 Turizmi

Pasuritë natyrore të Kosovës paraqesin burim të kualitetit të lartë për turizëm. Jugu malor i

<sup>29</sup><https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=2,23>

Kosovës ka potencial të madh për turizmin dimëror. Një nga mundësitë më interesante për investitorët e huaj në këtë rajon është Qendra e Skijimit në Brezovicë, në malet e Sharrit. Kjo qendër gjendet mes 1,700 dhe 2,500 m lartësi mbidetare. Ai ofron kushte të shkëlqyeshme të motit dhe borës si dhe sezon të skijimit nga nëntori deri në maj.

Brezovica mund të arrihet për një orë me makinë nga dy aeroporte ndërkombëtare, Aeroporti i Prishtinës (60 km) dhe i Shkupit (70 km), dhe gjendet në Parkun Kombëtar të Sharrit në Republikën e Kosovës, vargmalet e Brezovicës shtrihen në 39,000 hektarë me terren të lartë malor alpin dhe pyje.

Po ashtu, në Malet e Sharrit, në pjesën më jugore në kufi me Maqedoninë dhe Shqipërinë, Kosova ofron për privatizim rreth 22,000 hektarë të tokës së pashkelur në pjesët malore që i përkasin NSH "Sharrprodhimi".

Ky rajon ofron mundësi të shkëlqyeshme për turizëm si: skijimi, eko-turizmi, lëshimet me parashutë nga lartësitë malore, çiklizmi malor, ngjitja në shkëmbinj, ecja alpine, lundrimi me kajak, kalërimi, etj. Toka në Komunën e Dragashit ka bukuri magjepsëse. Ajo paraqet mundësi të jashtëzakonshme për eko-turizëm. Mundësi tjetër për investime është Qendra e Skijimit në Bjeshkët e Rugovës. Kosova është kryesisht e pasur me male, liqene artificiale dhe lumenj, gjë e cila ofron mundësi të mira për gjueti dhe peshkim.

Zeja e përhapur e punimeve artizanale në Kosovë, siç është Filigrani (me argjend), paraqet atraksion për turistët e huaj.

Përveç kësaj, Kosova ka potencial për zhvillimin e turizmit kulturor me objekte të ndryshme religjioze me vlerë të jashtëzakonshme kulturore dhe historike.

Janë të njohura burimet e famshme termale të Kosovës, për shkak të efekteve shëruese të tyre. Për këtë lëmi, investitorët e huaj do të gjejnë kërkesë të madhe në tregun rajonal dhe atë të brendshëm. Për më shumë, ju lutemi vizitoni faqen e Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) në internet.<sup>30</sup>

## 7.9 Vreshtaria

Kultivimi i rrushit dhe prodhimi i verës është traditë e moçme në Kosovë. Gjatë viteve të arta, vetëm në Rahovec, industria e verës kishte

kapacitet prodhimi deri në 50 milionë litra në vit. Në vitin 1989, eksporti i verës së Rahovecit arriti në 40 milionë litra, të cilat kryesisht u distribuuan në tregun gjerman.

<sup>30</sup><https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=2,23>

## REKOMANDIME

Investimet e huaja direkte në vendin tonë janë të një rëndësie strategjike, janë një faktor kyç për rritjen e aftësisë konkurruese të produkteve kosovare në tregjet ndërkombëtare, për mbështetjen e rritjes ekonomike dhe rritjen e konkurrencës dhe prodhimtarisë në tregjet e vendit, por fatkeqësisht që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008 e deri më tani ende nuk e kemi nivelin e dëshiruar të IHD-ve.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të analizohen pengesat me të cilat përballen investitorët e huaj Kosovë dhe ofrimi i rekomandimeve për masat që duhet ndërmarrë qeveria e nivelit qendror dhe lokal për t'i kapërcyer ato si dhe rekomandimet për masat e kujdesit të mëpasshëm për investitorët ekzistues me qëllim të ruajtjes dhe zgjerimit të investimit të tyre (ri-investimet). Këto rekomandime janë si rezultat i anketimit me 38 ndërmarrje të huaja përmes pyetësorit që përbante 47 pyetje duke u fokusuar më shumë në barrierat me të cilat përballen investitorët e huaj.

Gjithashtu, përmes këtij studimi Instituti IETL ka ofruar informacione të vlefshme në lidhje me potencialin dhe arsyet pse të investohet në Kosovë për të vazhduar një debat të gjerë për hartimin e një strategjie të re nacionale e zhvillimit ekonomik e cila do të ishte udhërrëfyes për reformat që duhet bërë në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik dhe tërheqjen e IHD.

Në këtë kontekst, rekomandimet drejtuar qeverisë në nivelin lokal dhe qendror gjithashtu janë ndarë në dy grupe:

1. Rekomandime për mbajtjen e investitorëve të huaj ekzistues
2. Rekomandime për tërheqjen e bizneseve të reja të huaja

### Rekomandime për mbajtjen e investitorëve të huaj ekzistues

#### a) Rekomandime për rritjen e besueshmërisë në institucione

Pushteti lokal, institucionet dhe agjencitë e tjera përkatëse komunale si dhe institucionet e nivelit qendror në juridiksionin e të cilave ndodhet dhe vepron biznesi i huaj luajnë rol të rëndësishëm për të akomoduar dhe krijuar mjedis miqësor për bizneset e huaja. Në këtë aspekt studimi tregon se ekziston pak besim në radhët e bizneseve të huaja ndaj qeverisë qendrore, si dhe ndaj autoriteteve lokale (mbi 28.6% kanë deklaruar se

nuk kanë besim në pushtetin lokal dhe qendror) si dhe mungon koordinimi në mes këtyre dy niveleve të qeverisjes. Në këtë drejtim Kosova ka krijuar një shembull jo të mirë të mos-koordinimit institucional për politikën dhe veprimet për përkrahje të investimeve të huaja. Edhe pse është themeluar Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA); Këshilli Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik (KKZHE); Komisioni Ndërmarrësor për Investime Strategjike; Këshilli i Investitorëve Evropianë (KIE) për të promovuar dhe mbështetur klimën e investimeve në Kosovë, sërish ende nuk ka koordinim të duhur ku ende janë së paku 5 (pesë) ministri të ekonomisë që kanë si synim rritjen e aftësisë konkurruese të sektorëve të caktuar dhe nxitjen e investimeve të huaja në vendin tonë. Një koordinim ndër-institucional dhe përqimi i një "mesazhi" të përbashkët institucional, është një ndër parakushtet kryesore për fuqizim të promovimit të mundësive për investime dhe rritje të IHD-ve. Qeveria duhet të krijojë një mekanizëm të përbashkët në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, me buxhet dhe resurse humane adekuate, si dhe me fuqi negociuese, në mënyrë që politikën e promovimit IHD-ve të jenë të koordinuara edhe me komunat, të fuqishme dhe përmbytësore.

#### b) Rekomandime për përmirësimin e mjedisit ligjor

Një tjetër gjetje me rëndësi është problemet me mjedisin ligjor, përkatësisht sundimin e rendit dhe ligjit. Edhe pse Kosova ka bërë shumë përparime në të bërit biznes si dhe në kompletimin e Kornizës Ligjore për Investime të Huaja Direkte (infrastruktura ligjore e rregulluar dhe e harmonizuar sipas standardeve të BE-së); sidoqoftë, përmirësimi i mjedisit ligjor, përkatësisht forcimi i sundimit të rendit dhe ligjit, sipas gjetjeve të hulumtimit është një ndër çështjet për të cilat qeveria e re e Kosovës duhet marrë masa më të shpejta që lidhen me fuqizimin e sundimit të rendit dhe ligjit, të shohim një efikasitet më të madh jo vetëm në trajtimin e kontesteve të natyrës komerciale që kanë qenë shqetësim i bizneseve, por edhe zbatimin e mirëfilltë të ligjeve. Gjykatat duhet të jenë efektive dhe të paanshme. Gjithashtu rekomandohet se është e nevojshme që të themelohet një gjykatë komerciale për t'i trajtuar çështjet e tilla gjyqësore ku merren vendime të drejta, transparente dhe me kohë dhe fuqizimi i tribunalit të arbitrazhit, e cila në masë të madhe lehtëson zgjidhjen e problemeve të biznesit në mosmarrëveshjet biznesore vendore dhe ndërkombëtare. Kur flasim për



fuqizimin e sundimit të rendit dhe ligjit duhet të shihen rezultate konkrete në luftimin e të gjitha formave të korrupsionit në të gjitha nivelet, në qeverinë qendrore dhe pushtetin lokal, meqë perceptimi i korrupsionit nga investitorët e huaj është shumë i lartë.

### **c) Rekomandime administrative**

Hulumtimi tregon se pengesat administrative (licencimi, kostoja, koha, marrja e lejeve ndërtimore, procedurat e tej zgjatura për përdorim të pronës komunale, mungesa e hapësirave biznese (zona ekonomike) vazhdojnë të krijojnë probleme për bizneset e huaja dhe flasin për një klimë jo shumë e favorshme biznese. Gjetjet e studimit korrespondojnë me treguesin e marrjes së lejes ndërtimore nga raporti i Bankës Botërore Të Bërit Biznes për vitin 2018, sipas të cilit, Kosova renditet e 122-ta ndër 190 vende. Si përfundim, Kosova duhet të përmirësohet në këtë tregues, meqë është sfidë dhe pengesë e madhe për bizneset e huaja kur vendosen dhe fillojnë biznesin në Kosovë.

### **d) Rekomandime për stimuj fiskalë**

Sipas bizneseve të intervistuar, sa i përket stimujve kryesorë të nevojshëm sugjerohet që Qeveria e Republikës së Kosovës (QeK) të marrë disa masa, siç janë vendosja e pushimeve tatimore; funksionalizim i plotë i zonave ekonomike të balancuara, krijimi i zonave të lira doganore; krijimi i më shumë hapësirave për parqet e biznesit. Këto masa janë një ndër elementet kryesore të zhvillimit të sektorit privat të cilat do të ndikojnë në ruajtjen e investimeve, zgjerimin (ri-investimet ose zgjerimet nga investitorët ekzistues) dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

### **e) Rekomandime për reformimin e sistemit të edukimit dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor**

Shumë firma raportojnë probleme gjatë punësimit të punëtorëve të rinj, kryesisht për shkak të përvojës apo kualifikimeve të pamjaftueshme. Zhvillimi i shkathtësitë është domosdoshmëri, synim afatgjatë dhe aspak i lehtë. Vëmendje e rëndësishme nga Qeveria e re, duhet kushtuar zhvillimit të kapitalit njerëzor, duke filluar nga reformimi i sistemit të edukimit në të gjitha nivelet e tij, me qëllim të nxitjes së ndërmarrësisë në mesin e gjeneratave të ardhshme, por edhe përmirësimin e raportit ndërmjet kërkesës dhe ofertës në tregun e punës. Është i nevojshëm një studim i veçantë për të caktuar me përpikëri se cilat programe duhet të futen në universitete dhe shkolla për të siguruar bazë të

mirë për punëtorë të kualifikuar.

### **f) Të tjera**

Kur flasim për infrastrukturën transportuese duhet theksuar se ka pasur investime në infrastrukturën rrugore, por ka ngecur mbrapa modernizimi i rrjetit hekurudhor dhe kjo është çfarë duhet të ndodh në qeverinë e re, pra vazhdimi i investimeve në rrjetin hekurudhor që do ta lehtësonte operimin e shumë bizneseve si dhe të eksporteve. Infrastruktura hekurudhore është e dalë afati, dhe vetëm riaktivizimi/rindërtimi i hekurudhës me Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë/Selanikun i cili lidhet me tregun evropian dhe aziatik konsiderohet se ia vlen të investohet me synimin për të arritur në portin detar shumë më shpejtë dhe shumë më lirë. Një shfrytëzim më i mirë i sektorit të minierave kërkon mes përmirësimeve tjera një modernizim të sistemit të hekurudhave.

Infrastruktura energjetike është e rëndësishme që si e tillë të mundësojë diferencimin e burimeve të energjisë të mos varemi vetëm nga konsumi i energjisë elektrike, por të shohim edhe burime të tjera.

Tutje, studimi tregon se paqëndrueshmëria politike luan rol të rëndësishëm në vendimin e investitorëve të huaj për të investuar kapitalin e tyre.

### **Rekomandime për tërheqjen e bizneseve të reja të huaja**

### **g) Rekomandime për strategji të bazuar në sektor**

Gjithashtu, Instituti IETL përmes këtij studimi jep informacion të vlefshëm në lidhje me potencialin dhe arsyet pse të investohet në Kosovë.

Promovimi i sektorit të TIK Qeveria e Kosovës ka njohur rëndësinë strategjike të industrisë së TIK-ut për zhvillimin ekonomik dhe transformimin strukturor drejt një ekonomie të bazuar në dije. Sipas Global Sourcing Association (GSA), Evropa Juglindore - rajoni i Kosovës është bërë një vend tërheqës për gjetjen e burimeve të nënkontraktimeve të shërbimeve të biznesit "outsourcing" (the Business Process Outsourcing –BPO), për shkak të kostos së ulët të stafit të njohja e gjuhëve të huaja. Por në anën tjetër bazuar në rezultatet e testit PISA të kohëve të fundit të cilat nxjerrën në pah se më shumë se dy të tretat e të rinjve në moshën 15 vjeçare u mungon njohuria themelore në shkencë, dhe mbi tri të katërtat e tyre janë në nivelin e duhur të leximit dhe matematikës, kjo

dukuri nënvizon faktin se qeveria duhet të bëhet më pro-aktive për të tërhequr më shumë IHD në sektorët e TIK-ut, e cila do të mundësonte kompanitë të TIK të arrijnë kontaktimin e kontratave më të mëdha me kontraktimit të jashtëm. Qeveria duhet të marra disa masa:

- Të përfshijë lëndë specifike jashtëshkollore në arsimin e lartë dhe në shkollën fillore, në mënyrë që të rritet konkurrueshmëria dhe atraktiviteti i këtij sektori.
- Dizajnimin e planprogrameve shkollore sipas nevojave dhe kërkesa të tregut.
- Mekanizmat e bashkëpunimit mes shkollave teknike, universiteteve.

Promovimi i energjise, minierave dhe sektorëve tjerë strategjike

Kosova ka mundësi të mëdha investimesh sektoriale në sektorë të veçantë, siç janë: energjia; energjia e ripërtëritshme; xehetaria; përpunimi i drurit dhe metaleve; agrobiznesi - përpunimi dhe paketimi i ushqimit; turizmi; tekstili etj. Një strategji e bazuar në sektor ia mundëson qeverisë qendrore dhe lokale të t'i fokusojnë resurset në sektorët që ofrojnë mundësitë më të mëdha të investimeve dhe maksimizojë përfitimet e IHD-ve në ekonominë vendore.

Përveç nga sa u tha më lart, ofrimi i stimujve të shumëllojshëm lidhur me sektorët kryesorë do të ndikonte më tej në vendimet e investitorëve për të investuar në këta sektorë. Në planin afatgjatë, fokusi i qeverisë duhet të jetë i orientuar drejt bindjes së investitorëve për të investuar në aktivitete që mund të sjellin përfitim të dukshëm për zhvillimin ekonomik dhe të krijojnë më shumë mundësi për punësim në Kosovë.

## **h) Stimulimi i diasporës së Kosovës për të investuar**

Qeveria e Kosovës mund të iniciojë krijimin e shoqatave të efektshme të biznesit në vendet ku është përqendruar pjesa më e madhe e diasporës kosovare, domethënë në Zvicër dhe Gjermani. Këto, ndër të tjera, do t'i ndihmonte investitorët potencialë nga diaspora përmes krijimit të mundësive për bashkimin dhe rritjen e kapitalit investues si dhe përmes ofrimit të më shumë informatave mbi sektorët me potencial për rritje të eksportit. Ligji për investime strategjike rregullon lirin nga tatimi prej 3 deri në 7 vjet për investimet e reja, varësisht nga vlera e investimeve dhe numri i të punësuarve. Ky vendim është i mirë, por duhet të krijohen lehtësira për të gjitha kategoritë e bizneseve (edhe për biznese të vogla e të mesme), e jo për biznese të mëdha në mënyrë të domosdoshme, sepse kjo e limiton mundësinë e njerëzve që kanë dëshirë, kanë shkathtësi, kanë kapacitet

për të investuar e sidomos krijimin e kushteve kushte më të mira, që mërgimtarët tanë të investojnë kapitalin e tyre në Kosovë.

## **i) Privatizimi i pronave dhe pasurive shoqërore**

Deri më tani, Kosova ka shënuar përparim në privatizimin e pronave ose pasurive shoqërore. Investitorët potencialë, të huaj apo vendas, të gjithë trajtohen njësoj, në procesin e tenderimit. Sipas ligjit, në raste të veçanta, Qeveria e Republikës së Kosovës (QeK) ka të drejtë të negociojë drejtpërdrejt me investitorët e mundshëm pa kaluar nëpër procedurat tradicionale të tenderimit. Sfidë për qeverinë e ardhshme rishikimi infrastrukturës ligjore për menaxhimin e pronës.

## REFERENCES

- Adewumi, S., (2006). The Impact of FDI on Growth in Developing Countries: An African Experience.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Odën Ekonomike të Kosovës, Official Monitor No. 17/2007, 01.10.2007. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Zonat Ekonomike, Official Monitor No. 6/12, Mars 2013. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, Official Monitor No. 2/08, Janar 2016. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja, Official Monitor No. 1/09, Janar 2014. Ligji për Ndërmarrjet Publike, Official Monitor No. 31/2008, 15.06.2008, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Investime Strategjike, Official Monitor No. 6/08, Shkurt 2017. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, Official Monitor No. 6/2006, 01.11.2006. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.
- Anderson, T., (2010): U.S. affiliates of foreign companies' operations in 2008, Survey of Council of the European Union (EU). 2015.
- Consilium Europa. Qasur më 4 prill 2018. Marrë nga:  
(<http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/27/kosovo-eustabilisation-association-agreement/>)
- Goedhuys, M., (2007). Learning, product innovation and firm heterogeneity in developing countries: Evidence from Tanzania, Industrial and Corporate Change.
- The evaluation of Foreign Direct Investments and their impact in the economics of some transitions countries: the case of Kosovo. Halil, Kukaj. Alishani, Anera. 2017.  
Marrë nga:  
(<https://www.ingentaconnect.com/content/doi/24103918/2017/00000003/00000001/art00040>)
- Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences. Vol. 3 No.1 March 2017. Qasur më 11 mars 2018. Hajrizi, E. Hasani, M. 2013. "Kosovo Investment Climate and Foreign Investors' Perception". The International Federation of Automatic Control. June 6-8. Accessed March 11, 2018
- 2017 Tax Summary Kosovo. Marrë nga:  
<https://www.pwc.com/ks/en/publications/2017%20Kosovo%20Tax%20Summary.pdf>
- Foreign Direct Investment in Kosovo and possible avenues for change Kyle Conahan M.A. in Political Science With a Concentration in European Union Policy Studies James Madison University. Marrë nga  
<https://pdfs.semanticscholar.org/4845/b598dc93484e7ecd3b2d559999e06cfa2c4f.pdf>
- Manuali për Investitorët e Huaj, shkruar nga Sytrime Dervisholli, udhëheqëse e Departamentit të Tregtisë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, botuar nga Konrad Adenauer Stiftung (2017). Marrë nga:  
<https://www.kas.de/en/web/kosovo/laenderberichte/detail/-/content/foreign-investor-manual>
- How 'friendly' is Kosovo for Foreign Direct Investments: A Policy Review of Gaps from a Regional Market Perspective. Marrë nga:  
<http://www.legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2017/03/How-friendly-is-Kosovo-for-Foreign-Direct-Investments-Policy-Report-GLPS.pdf>

The comparison of the tax rates between the republic of Kosovo with countries in region and the European union countries Vehbi Imeri, Phd candidate economic faculty, "Biznesi", Pristine. Marrë nga: <https://eujournal.org/index.php/esj/article/viewFile/873/916>

The Legal Framework of Foreign Direct Investments in Kosovo, Kreshnik KAÇIU1 , Lulzim EJUPI2. Marrë nga: <file:///C:/Users/Dell/Downloads/4397-15735-1-PB.pdf>

The Legal System for Strategic Investments in the Republic of Kosovo Hana Bahtijari Jakupi PhD Student, Faculty of Law, University of Pristina, Republic of Kosovo, Address: Pristina, Kosovo. Marrë nga: <file:///C:/Users/Dell/Downloads/SSRN-id3375511.pdf>

## Internet Sources

Kuvendi i Kosovës: <http://www.assembly-kosova.org/?krye=home&lang=en>

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës: <http://www.bqk-kos.org>

Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropë Qendrore (5 maj 2017). Marrë nga [www.cefta2006.com](http://www.cefta2006.com).

<http://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics>

<http://ec.europa.eu/enlargement/archives/ear/kosovo/kosovo.htm>

[http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/index\\_en.htm](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/index_en.htm)

<http://www.assembly-kosova.org/>

<http://www.mti-ks.org/>

<http://www.worldbank.org/en/country/kosovo>

<https://ec.europa.eu/eurostat/web/structural-business-statistics/global-value-chains/fdi>

<https://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=2,15> <http://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics>

[https://unctad.org/en/Docs/wir2007p4\\_en.pdf](https://unctad.org/en/Docs/wir2007p4_en.pdf)

<https://www.marketopportunities.fi/home/2019/ict-sector-in-kosovo/>

<https://www.oecd.org/daf/inv/investmentstatisticsandanalysis/40193734.pdf> (OECD Benchmark Definition of Foreign Direct Investment FOURTH EDITION 2008)

<https://www.rks-gov.net/EN/f134/finance-taxes-customs/taxes>

<https://www.rks-gov.net/EN/f139/infrastructure/roads>

Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve (1 maj 2017), marrë nga <https://icsid.worldbank.org>.

Agjencia e Kosovës për Promovimin e Investimeve (7 maj 2017). Marrë nga [www.investks.org](http://www.investks.org).

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (2 maj 2017). Marrë nga [www.arbk.org](http://www.arbk.org).

Oda Ekonomike e Kosovës (8 maj 2017). Marrë nga [www.oek-kcc.org](http://www.oek-kcc.org).

Regjistri i Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtarë: <http://www.arbk.org/>

Gazeta Zyrtare e Kosovës (1 mars 2017). Marrë nga [www.gazetazyrtare.com](http://www.gazetazyrtare.com).

Ministria e Zhvillimit Ekonomik: <http://mzhe.rks-gov.net>

Ministria e Financave <http://mf.rks-gov.net/>

Ministria e Punëve të Jashtme: Republika e Kosovës. 2015. "Zonat Ekonomike". Republika e Kosovës

Ministria e Punëve të Jashtme. Qasur më 11 mars 2018.

Zyra e Kryeministrit, (5 prill 2017). Marrë nga <http://www.kryeministri-ks.net>.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, (7 maj 2017). Marrë nga [www.mti-ks.org](http://www.mti-ks.org).

Korporata për Investime Private të Jashtme (5 mars 2017). Marrë nga <http://www.opic.gov/>.

Organizata Botërore e Tregtisë (1 qershor 2017). Marrë nga [www.wto.org](http://www.wto.org).

Kuvendi i Republikës së Kosovës (5 prill 2017) Marrë nga <http://www.assemblykosova.org>.

Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare (3 prill 2017), marrë nga [www.uncitral.org](http://www.uncitral.org).

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë: <http://www.mti-ks.org/>

Administrata Tatimore e Kosovës: <http://www.atk-ks.org/en/>

Banka Botërore – Kosovë: <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo>  
[www.beinkosovo.com](http://www.beinkosovo.com)

Biznes i huaj aktual i intervistuar: [www.arbk.org](http://www.arbk.org).

<https://www.pwc.com/ks/en/publications/2017%20Kosovo%20Tax%20Summary.pdf>

